

B I B L I O G R A F I

PALOK DAKA

KONTRIBUT PËR BIBLIOGRAFINË E GJUHËSISË SHQIPTARE (II)

(1899 - 1904)

- 1899 -

163. - A.B.C. . . . : Shqypnia ë perfolun ner t'mdhaj. - *ALBANIA, Bruxelles, 1899, Vit'i III, fq. 41-42, 65-67.*
Përmban edhe toponime.
164. - ABECEJA shqip. L'Alfabet Albanais. Te Alvanikon Alfaviton. - *DITËRRË-FENJËSI (Kalendari) KOMBIAR, Sofje, 1899, Mot'i tretë, fq. 160.*
Jepet një pasqyrë e alfabetit të shqipes (alfabeti i Stambollit) me shembuj dhe i krahasuem me alfabetin frang e grek.
165. - ABETAREIA shqip. - *SHQIPETARI (Albanezul) Bukuresht, te Kolojeku te Diel 17, 1899, Viti II, Nr. 2, fq. 3-4.*
U bahet thirrje shqiptarëve që të shkruajnë shqip me alfabetin latin. Artikulli botohet në shqip, rumanisht e frangjisht.
166. - ABRAMI, THOMA: Emra druresh. - *ALBANIA, Bruxelles, 1899, Vit'i III, fq. 64.*
Botohet një listë e shkurtën me emna drurësh frutorë.
167. - BERNARDO Arciprete Bilotta. - *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Maggio 1899, Anno III, Nr. 9, fq. 1-2.*
Botohen të dhana biografike mbi Bilotën, të shoqnueme me fotografi. Bilotat, thuhet ndër të tjera, asht edhe autor i një vepre ende të pambarueme me titull "Il dizionario filologico albanese".
168. - BIBLIOGRAFIA Albanese: Quadro elementare per la scrittura e per la lettura della lingua albanese fatto dal Professor Enrico Cremonese [Bibliografi shqipe: Kuadër fillestar për shkrimin dhe për leximin e gjuhës shqipe, punue nga prof. Enriko Kremoneze]. - *LA NUOVA ALBANIA, Napoli, 10 Febbraio 1899, Anno I, Nr. 18, fq. 7.*
Metodë fillestare për mësimin e gjuhës shqipe. Ndahet në dy pjesë: shkrimi e leximi.
169. - CA VITE të përmenur. - *DITËRRË-FENJËSI (Kalendari) KOMBIAR, Sofje, 1899, Mot'i tretë, fq. 30-32.*
Data të shënueme: 1) Njoftohet se më 1879 u krijue në Konstantinopol një Shoqni nën kryesinë e Sami Frashërit; 5) Më 1881 në Bukuresht themelohet Shoqnia "Drita" e cila më 1888 mori emrin "Dituria" (Shkrue me alf. e Stambollit)
170. - CHINIGO, FRANCESCO: Impressioni di Viaggio [Përshlypje udhëtimi] *LA NAZIONE ALBANESE Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Agosto 1899, Anno III, Nr. 15, fq. 3-5 (Da Vallona a Durazzo) [Nga Vlona në Durrës]; Nr. 20, fq. 2-3 (Da Alessio a Scutari) [Nga Lezhja në Shkodër]; Nr. 21, fq. 2-5, Nr. 22, fq. 3 (Albania e Albanesi) [Shqipnia dhe Shqiptarët]; Nr. 23, fq. 4-5, Nr. 24, fq. 4-6 (Scutari d'Albania) [Shkodër Shqipni]; Anno IV, 1900, Nr. 1, fq. 5-6, Nr. 3, fq. 3 Nr. 4, fq. 6-7 (U Vilajet di Scutari d'Albania) [Vilajeti i Shkodrës Shqipni]; Nr. 7, fq. 4-7 (Da Scutari a Cetinje) [Nga Shkodra në Cetinë]; Nr. 15, fq. 4-7 (Da Cetinje ad Antivari) [Nga Cetina në Tivar].*
Përmban edhe toponime e antroponime.

171. — XII CONGRESSO Internazionale degli Orientalisti in Roma [Kongresi i XII Ndërkombëtar i orientalistëve në Romë]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Ottobre 1899, Anno III, Nr. 19, fq. 1-7.*
- Në këtë numër jepet një përmbledhje e punimeve që u zhvilluan në Kongresin e XII Ndërkombëtar të Orientalistëve në Romë. Për çeshtjet shqiptare u diskutue në Sekcionin e II: *Gjeografia dhe etnografia e Orientit* si dhe në Sekcionin e XI: *Greqia dhe Orienti*. Për gjuhësinë diskutoi *Bernardo Bilota* me temën "Antichità della lingua albanese". Prof. *Kurt Hassert*, i Universitetit të Tybingenit (Gjermani) diskutoi mbi këto çeshtje: për udhëtimet e tija nëpër Shqipëri në vjetet 1891, 1892 e 1897, të cilat i dhanë mundësi të njihet me kulturën dhe traditat e popullit shqiptar; mbi nevojën e hartimit të një fjalori të gjuhës shqipe dhe të një fjalori italisht-shqip e shqip-italisht si dhe mbi nevojën e adoptimit të një alfabeti të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Në këtë Kongres *Jeronim De Rada* lexoi monografinë me titull "Caratteri della lingua albanese e i suoi monumenti nell'età preistorica" (Një pjesë e kësaj monografie botohet në këtë numër, një pjesë në Nr. 20, fq. 5-7 të kësaj reviste). Diskutuen edhe *Anselmo Lorekjo* e *Dervish Hima*.
172. — CREMONESE, ENRICO: Gli Albanesi del Molise [Arbëneshët e Molisës]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 30 Novembre 1899, Anno III, Nr. 22, fq. 5-7.*
- Përmban edhe toponime e antroponime.
173. — DARA, GJON: Antichità della lingua albanese [Lashtësia e gjuhës shqipe]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 30 Novembre 1899, Anno III, Nr. 22, fq. 4-5.*
- Autori paraqet një përmbledhje të studimit të Ed. Shnajderit (Schneider) mbi lashtësinë e gjuhës shqipe si dhe pikëpamjet e F. Krispit.
174. — FIALE shqipe te ngraha mé ghëranishte (Allemand). — *SHQIPERIA, Bucuresci, 22 te Shkurtit 1899, Vit II, Nr. 58, fq. 7.*
- Botohen 17 fjalë shqip-gjermanisht.
175. — FIALE shqipe të ngraha me sanskriten. — *SHQIPERIA, Bucuresci, 1 te Shkurtit 1899, Vit II, Nr. 57, fq. 1.*
- Botohen 12 fjalë shqip-sanskritisht, 4 fjalë shqip-baske, 5 fjalë shqip-keltisht dhe 5 fjalë shqip-gotisht.
176. — GEANTIN, G.E. Për Alfabetin. — *SHQIPERIA, Bucuresci, 22 te Shkurtit 1899, Vit II, Nr. 58, fq. 4-5.*
- Në lidhje me caktimin përfundimtar të alfabetit, A. këshillohet të kihen parasysh zanoret e gjata dhe shenjat diakritike, veçanërisht hundoret.
177. — KNNIMET é dijéja é Shqyptarvé qe n'filhes t'vet é déri n'koh t'on. — *ALBANIA, Bruxelles, 1899, Vit III, fq. 141-144, 147-148.*
- A. shkruen, ndër të tjera, për damin e madh që gjuhët e hueja si turqishtja, italishtja, etj. i kanë sjellë gjuhës shqipe. Kujton traditat e shkrimtarëve të parë si Bogdanin, Budin, etj. dhe veprat që këta shkruene në gjuhën shqipe. Manëfund porositi që në shkollat tona të mësohet vetëm gjuha shqipe dhe jo gjuhët e hueja.
178. — LIBRA të ra. — *ALBANIA, Bruxelles, 1899, Vit III, fq. 152.*
- Njoftohet se Dr. Holger Pedersen i botoi një studim të tijin prej 60 faqesh me titull *Gryketoret në ghuken shqip* (Die Gutturale im Albanesischen) në gjuhën gjermane. Ky studim asht botue në revistën gjermane *Zeitschrift fuer vergleichende Sprachforschung auf dem Gebiete der indogermanischen Sprachen*. (Shih edhe versionin frangjisht, fq. 157)
179. — NAKDO MONICI (Pseud. i *Ndoc Nikaj*): Ghikim i paa dijé. — *ALBANIA, Bruxelles, 1899, Vit III, fq. D5-D8.*
- Përgjigjia e A. një farë Ypsilonit që ka shkruar kundër shq. "Bashkimi".
180. — NGJARJET e motit 1898. — *DITËRRËFENJËSI (Kalendari) KOMBIAR, Sofje, 1899, mot i tretë, fq. 9-10.*

- Njoftohet se me 2 nandor 1898 u themelue në Sofje Shoqëria Kombëtare e Shqiptarëve me emnin "Bashkimi". Botohet edhe programi i Shoqërisë (shih Nr. 147) (Shkrue me alf. e Stambollit).
181. — NOTES diverses : Nous avons publié [Shënime të ndryshme : Kemi botue]. — *ALBANIA, Bruxelles, 1899, Vit III, fq. 111.*
H. Pedersen shkruen se fjala shqipe *njelm* nuk do të thotë *i gjelbërt* (fr. vert) siç asht dhanë në një përkthim të "Albania"s, po *i kripur* (fr. sale). Red. tue e gjetë me vend këtë vrejtie e fandonerun albanologun e Kopenhagës.
182. — NOTES diverses: Parmi les savants . . . [Shënime të ndryshme: Nga dijetarët . . .]. — *ALBANIA, Bruxelles, 1899, Vit III, fq. 13.*
Ndër dijetarët që interesohen për gjuhën shqipe meriten të përmendet, shkruhet në këtë shënim, edhe Dr. H. Myler (Müller) nga Utrehti, i cili asht i njohun edhe për disa punime në gjuhën greke.
183. — P.B.: Emra druësh, lulesh e barishtesh. — *ALBANIA, Bruxelles, 1899, Vit III, fq. D. 9.*
Listë e shkurtën në rend alfabetik me emna drurësh, lulesh e barishtesh në gjuhën shqipe.
184. — PER la storia delle nostre Colonie . . . shih Nr. 144 (1898)
185. — SCHNEIDER, ED.: Antichità della lingua albanese [Lashtësia e gjuhës shqipe]. *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 31 Agosto, 1899, Anno III, Nr. 16, fq. 6-7; Nr. 17, fq. 5-7; Nr. 18, fq. 7-8; Nr. 19, fq. 7-8.*
Studimi i këtij A. lidhet me artikullin e prof. Luigji Çeqi (Luigi Ceci) me titull "L'iscrizione antichissima del Foro e la storia di Roma". Enigmën e mbishkrimit që u gjet në Forumin e Romës, për të cilin bahet fjalë në artikullin e përmendun, E. Shnajderi e zbërthen me anën e gjuhës shqipe. (Shih edhe Nr. 195, 211, 224).
186. — SCHNEIDER, ED.: XII Congresso degli Orientalisti [Kongresi i XII i Orientalistëve]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 30 Settembre 1899, Anno III, Nr. 18, fq. 4-5.*
Letër drejtue presidentit të Kongresit XII Ndërkombëtar të Orientalistëve në Romë, me të cilën E. Shnajderi njofton se pranon të marrë pjesë në këtë Kongres me dy kumtesa: 1) gjuha shqipe dhe leximi i mbishkrimeve jo të klasifikueme, 2) misteret kabire (cibirici) të zbulueme me anën e gjuhës shqipe. Ma poshtë Sh. thekson se gjuha shqipe asht e domosdoshme për ata që duen të deshifrojnë mbishkrimet oske, umbre, etruske e fryge.
187. — SCHNEIDER, ED.: Etruschi e Albanesi [Etruskë dhe Shqiptarë]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Maggio 1899, Anno III, Nr. 9, fq. 2-4.*
Zbërthime mbishkrimesh etruske me ndihmën e shqipes.
188. — TE RA. — *ALBANIA, Bruxelles, 1899, Vit III, fq. 121.*
Njoftohet vdekja e Imz. de Harlez, profesori Universitetit të Luvenit (Louvain). Kohët e fundit, shkruhet në këtë njoftim, de Harlez qe marrë edhe me gjuhën shqipe.
189. — TE RA. — Shoqëria e Bashkimit. — *ALBANIA, Bruxelles, 1899, Vit III, fq. 101.*
Njoftohet se Shoq. "Bashkimi", që u themelue në Shkodër, ka hartue një abece (alfabet) që ndryshon pak nga ai i *Albania-s*. Red. shkruen se me marrëveshje do të përpiqet që të bahet afrimi i këtyne dy alfabeteve (shih edhe versionin frangjisht, fq. 111).
190. — TR[ANK]SP[IRO] (Pseud. i Faik Konicës): Memedhe apo atdhe? — *ALBANIA, Bruxelles, 1899, Vit III, fq. 118-119.*
Në diskutimin e hapun rreth përdorimit të fjalës memëdhe apo atdhe, A. shkruen se asht ma drejtë të përdoret fjala *atdhe* se sa *mëmëdhe*.
191. — TRUHELKA, Dr. ÇIRO: Permi pleqnijen e Shqyptarve. — *ALBANIA, Bruxelles, 1899, Vit III, Nr. 1, fq. 18-19.*
Jepen disa etimologji toponimesh e antroponimesh, të cilat, simbas A., dëshmojnë për origjinën ilire të gjuhës së sotme shqipe.
192. — VARIA : Accademia Albanese [Akademi Shqiptare]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 20 Ottobre 1899, Anno III, Nr. 20, fq. 8.*

- Në rubrikën "Të ndryshme" shkruhet se kjo akademi (Shoq. Bashkimi e Shkodrës) ka për qëllim vetëm studimin e gjuhës shqipe në Shqipëri.
193. — VARIA : L'Accademia albanese [Akademia Shqiptare]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Dicembre 1899, Anno III, Nr. 23, fq. 7.*
Njoftohet se në Shkodër u botue një alfabetar dhe një libret me vërejtje rreth alfabetarit.
194. — VARIA: Albanologhi illustri [Albanologë të shquem]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Settembre 1899 Anno III, Nr. 17, fq. 8.*
Njoftohet se Dr. Kurt Hassert, profesor i Universitetit Tybingen në Vyrtemberg (Tübingen në Würtemberg), do të vizitojë Kolonitë Shqiptare të Italisë, në lidhje me plotësimin e një libri të tij mbi shqiptarët.
195. — VARIA: Antichità della lingua albanese [Lashtësia e gjuhës shqipe]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Luglio 1899, Anno III, Nr. 13, fq. 8; Nr. 14, fq. 7.*
Në një korrespondencë nga Konstantinopulli, Ed. Shnajder shkruen se mbishkrimi i gjetun në stelen e zbulueme në Forumin Roman dhe që daton nga shek. VI ose VII para Erës së re, mund të deshifrohet me ndihmën e shqipes. (shih edhe Nr. 185, 211, 224).
196. — VARIA: Colonie Albanesi in Italia [Kolonitë Shqiptare në Itali]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 30 Aprile 1899, Anno III, Nr. 8, fq. 7.*
Përmban edhe toponime. Botohen emnat e katundeve të Kolonive Arbëneshë të Italisë në rend alfabetik, simbas grupeve të emigrimeve shqiptare, tue fillue nga vjeti i parë i emigrimit që u ba më 1444 e deri më 1774.
197. — VARIA: XII Congresso Internazionale degli Orientalisti [Kongresi i XII Ndërkombëtar i Orientalistëve]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 30 Ottobre 1899, Anno III, Nr. 19, fq. 8.*
Njoftohet se Kongresi i XII Ndërkombëtar i Orientalistëve u dha fund punimeve. Në këtë kongres Shqipëria u përfaqësua nga këta persona: 1) Baronsha Jozefina de Knorr, Gresten (Austr. e Poshtme), 2) Prof. Kav. Jeronim De Rada, Makia Albaneze (Kogzenca), 3) Dervish Hima, përfaqësues i Shoqisës Shqiptare t. Bukureshtit, 4) Arciprete Bernardo Bilota, Frashineto (Kozenca), 5) Luigji Lorekjo, Palagorio (Katancaro), 6) Anselmo Lorekjo, president i Shoqatës Kombëtare Shqiptare në Itali. Në fund thuhet se Eduard Shnajderi për arsye objektive nuk mundi të marrë pjesë në këtë Kogres.
198. — VARIA : Congresso degli Orientalisti [Kongresi i Orientalistëve]. *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 30 Settembre 1899, Anno III, Nr. 18 fq. 8.*
Njoftohet se në Kongresin e XII të Orientalistëve që do të mbahet në Romë me 4 tetor 1899, do të marrin pjesë përfaqësues nga të katër anët e botës. Për çeshtjet e gjuhës shqipe në këtë kongres deri tashti dihet se do të marrin pjesë këta persona: baronesha Jozefina de Knorr, Jeronim De Rada, Eduard Shnajder, Ab. Sfinis, Bernardo Bilota dhe Dervish Hima.
499. — VARIA: Per l'alfabeto nazionale [Për alfabetin kombëtar]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Maggio 1899, Anno III, Nr. 9, fq. 7.*
Njoftohet se djaloshi shqiptar Luigj Gurakuqi student në Kolegjin e Shën Adrianit në Shën Dhimitër Korona, ka shkruar një artikull të gjatë mbi unifikimin e alfabetit kombëtar. Për mungesë vendi botohen vetëm disa radhë të letrës që autori i ka dërgue redaksisë. Në të thuhet se L. Gurakuqi ka studjue me vemendje të gjitha alfabetet egzistuese tue dhanë për secilin gjykimin e vet dhe tue përfundue se asnjëni prej tyre nuk asht i përsosun.
200. — VINCENZO Dorsa. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Gennaio 1899, Anno III, Nr. 1, fq. 1-2.*
Botohen të dhana biografike mbi V. Dorsa. Ndër të tjera shkruhet se V. Dorsa asht edhe autor i veprës me titull *Studi eti-*

mologici della lingua albanese, messe a confronto con la latina e la greca, Cosenza, 1862.

— 1900 —

201. — ARCIPRETE Cav. Pietro Camodeca dei Coronei — *LA NAZIONE ALBANESE-Pallagorio (Catanzaro) Italia, 31 Gennaio 1900; Anno IV, Nr. 2, fq. 4.*
Botohen të dhana biografike si dhe një fotografi e arbëneshit P.K. dei Koronei. Ndër të tjera shkruhet se Koronei asht tue botue në formë dispense një fjalor shqip-italisht e italisht-shqip.
202. — ATDHETARI I KOSOVES (Pseud. i Mati Logorecit): Mennime permi shkrim te ghuhes kombetare. — *ALBANIA, Bruxelles, 1900, Viti IV, Nr. 1 fq. 36-37.*
Themelimin në Shkodër të "Shoqnis së Bashkimit të gjuhës shqipe", autori e quen "Shoqnija e t'shperndamit e t'degamit te gjuhës . . ." tue kritikue njëkohësisht edhe alfabetin e kësaj shoqnie. A. çfaq disa mendime të vetat në lidhje me shkronjat e alfabetit. Prek edhe çeshtje të ortografisë (të mos shkruhet *m'a, t'a po ma, ta pa* apostrof etj.). Merret edhe me etimologjinë e fjalës *sakt*.
203. — BIBLIOGRAPHIE: RUMAENSKE STUDIËR, par Kr. Sanfeld Jensen, Kopenhague, 1900 — I vol. in 8^o de 136 pp. [Studime Rumune nga Kr. Sanfeld Jensen, etj.]. — *ALBANIA, Bruxelles, 1900 Viti IV, Nr. 2, fq. 64.*
Njoftohet se Kr. Sanfeld Jensen botoi veprën "Studime Rumune" në gjuhën daneze. Në këtë veper trajtohet edhe infinitivi i rumanishtes, i krahasuem me infinitivin e gjuhëve të tjera ballkanike, ndër to edhe me atë të shqipes.
204. — CERVANTES, le plus ancien albanologue [Servantesi, albanologu ma i vjetër]. — *ALBANIA, Bruxelles, 1900, Viti IV, Nr. 6, fq. 127-128.*
Në këtë artikull thuhet se M. Servantesi e njëjtte shqipen përpara kalorësit flamand Arnold fon Harfit I). Servantesi mbasi u kap rob në betejën e Lepantos u ba skllavi i një shqiptari të quejtun Mami (Mema?), nga i cili ma vonë mësoi shqipen. Shkrimtari i madh, shkruhet ma poshtë, e kujton këtë episod në disa novela e tregime të tijat.
205. — CHINIGÓ, FRANCESCO: Impressioni di Vaggio . . . shih Nr. 170 (1899).
206. — DE RADA, GIROLAMO: Per la cattedra di Lingua Albanese nel R. Istituto Orientale in Napoli [Për katedrën e Gjuhës Shqipe në Institutin Mbr. Oriental në Napoli]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 30 Novembre 1900, Anno IV, Nr. 22, fq. 4-5.*
Letra e përgjigjes që De Rada i ban Institutit Mbr. Oriental të Napolit në lidhje me hapjen e katedrës së gjuhës shqipe.
207. — DIZIONARIO Pelasgo-Albanese ed Italiano [Fjalor pellazgo-shqip dhe italisht]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Marzo 1900, Anno IV, Nr. 5, fq. 9.*
Botohet parathania e një fashikulli të fjalorit shqip-italisht të Pietro Kamodeka dei Koronei.
208. — ETIMOLOGIA del vocabolo Shqipëria [Etimologjia e fjalës Shqipni]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 30 Giugno 1900, Anno IV, Nr. 12, fq. 7.*
Nxjerrë nga libri i Z. Skiròit: *Te Dheu i Huaj*, fq. 64-65 Simbas këtij autori origjina e fjalës *shqip* *Shqipëri* lidhet me fjalët shqipe *shkrep* (si banorë malesh) e *shkreptimë* (i shpejtë si rrufeja) etj.
209. — FIALESIA é ré é ghuhes shqypé. — *ALBANIA, Bruxelles, 1900, Viti IV, Nr. 3, fq. 73-74.*
Me kërkesën e një lexuesi, shpallet një listë fjalësh të rralla shqipe (me përkthimin latinisht e turqisht) që janë përdorun në shkrimet e kësaj reviste.
210. — I DESPOTI di Epiro e di Arta [Despotët e Epirit dhe të Artës]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Settembre 1900, Anno IV, Nr. 17, fq. 7-9.*
Përmban edhe toponime e antroponime.

1) Arnold fon Harfi ka jetue në shek. XV. Fjalorthi i tij mban datën 1496. M. Servantesi ka lindun më 1547 dhe ka vdekun më 1616. Beteja e Lepantos u ba më 1571. (Sh. i A.)

211. — IL "TEMPLUM" antichissimo del Foro Romano ["Tempulli" i stërlashtë i Forumit Roman]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Maggio 1900, Anno IV, Nr. 9, fq. 7-8.*
 Artikull i redaksisë në lidhje me një mbishkrim të zbuluem në Forumin Roman. Deshifrimi i këtij mbishkrimi, shkruen Ed. Shnajder, mund të bahet vetëm me anën e një gjuhe paralatine, d.m.th. me pellazgjishten. Prof. Luigji Çeçi, i Universitetit të Romës, tezën e Shnajderit e quen fantastike. Redaksia këtu mban anën e Shnajderit. (shih edhe Nr. 185 195 e 224)
212. — KALENDARI i shqyponëtorvé. — *KALENDARI I MALËVË, Bruxelles, 1900, fq. 49-59.*
 Kristoforidhi fjalën *shqyponj*, shkruhet, e ka përdorun me kuptimin *flas shqyp*. *Shqyponjëtorë* — vazhdon artikulli — do të quejmë gjuhëtarët që e dinë dhe merren me gjuhën shqipe [albanologët]. Ma poshtë botohen fotografi dhe shënime mbi jetën e veprat e Nelko Kristoforidhit, Emile Legrandit, Gustav Majerit dhe Holger Pedersenit.
213. — KONICA; FAIK BE: Dhëlperit'e grekve. — *ALBANIA, Bruxelles, 1900 Viti IV, fq. 55-56.*
 Jepen të dhana biografike mbi A. Kulluriotin. (shih edhe versionin frangjisht "Une singulière proposition de la presse grecque", fq. 63-64).
214. — LA CATTEDRA di lingua Albanese nel R. Istituto Orientale di Napoli [Katedra gjuhës shqipe në Institutin Mbr. Oriental të Napolit]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Novembre 1900, Anno IV, Nr. 21, fq. 4.*
 Botohet shkresa e Institutit Oriental të Napolit drejtue Jeronim De Radës, me anën e të cilës i njoftohet se tue nisë nga ky vit do të fillojë mësimi i gjuhës shqipe në këtë Institut, nën drejtimin e Prof. Zef Skirçit.
215. — LKENI I HASIT (Pseud. i *Shtjefen Gjeçovit*): Emna barnash. — *ALBANIA, Bruxelles, 1900, Viti IV, Nr. 4, fq. 89.*
 Botohet një listë e shkurtën me emna barnash e bimësh.
216. — LKENI I HASIT (Pseud. i *Shtjefen Gjeçovit*): Emna lulesh — drûsh — ferhash — *ALBANIA, Bruxelles, 1900, Viti IV, Nr. 5, fq. 107.*
 Listë me emna lulesh, drujshe e ferrash, pa ndonjë përshkrim dhe pa tregue vendin se ku janë mbledhë.
217. — L[KENI I]H[ASIT] (Pseud. i *Shtjefen Gjeçovit*): Emnat e t'nyjmeve. — *ALBANIA, Bruxelles, 1900, viti IV, Nr. 4 fq. 89.*
 Botohen në shqip emnat e 12 ngjyrave.
218. — LORECCHIO, ANSELMO: L'insegnamento della lingua albanese in Italia [Mësimi i gjuhës shqipe në Itali]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 31 Dicembre 1900, Anno IV, Nr. 24, fq. 3-4.*
 Kryeartikull kushtue randësisë së mësimit të gjuhës shqipe në Institutin Oriental të Napolit.
219. — MA é madhia nnohine per Komin Shqypptar me 1899. — *KALENDARI I MALEVE Bruxelles, 1900, fq. 47.*
 Flitet për themelimin e Shoq. "Bashkimi" në Shkodër.
220. — MANGU i fjalevé ne ghuhe t'one. Ghera te paperkthyeshme sheip. — *ALBANIA, Bruxelles, 1900, Viti IV, Nr. 12, fq. E, 76-E, 78.*
 Botohet në frangjisht poema "Le Cor" e Alfred de Vigny. Në fund shpallet një listë me 23 fjalë frange të papërkthyeshme, për të cilat u kërkohet lexuesve që t'u gjejnë kuptimin shqip.
221. — NI ATDHETAR I KOSOVËS (Pseud. i *Mati Logorecit*): Mesime permi ghuhe shqyp. — *ALBANIA, Bruxelles, 1900, Viti IV, Nr. 5, fq. 105-106.*
 A. trajton shkurtimisht nyjet e shqipes dhe disa nga parashetësat shqipe: *per-, kaper-, sh-, li-, t-, ter-, ma-*.
222. — NI ATDHETAR I KOSOVËS (Pseud. i *Mati Logorecit*): Prape permi abetar. — *ALBANIA, Bruxelles, 1900, Viti IV, Nr. 6, fq. 118-120.*
 A. shkruen se asht keqkuptue artikulli i tij, botue në Nr. 1 fq. 36-37 (shih Nr. 202). Ai shkruen se asht për bashkimin e alfabetëve në një të vetëm dhe kundër krijimit të të reja. Nga ortografitë (alfabetet) që egzistojnë, A. pëlqen atë të Bukureshtit.

223. — PÉSCINDARIA e Ghin Bue Spates. — *ALBANIA, Bruxelles, 1900, Viti IV, Nr. 9, Fq. E, 21 — E, 23.*
Përmban edhe toponime e antroponime (zotnimet dhe pasardhësit e Gjin Bue Shtpatës).
224. — SCHNEIDER, ED.: II "Templum" antichissimo del Foro Romano ["Tempulli" i stërlashtë i Forumit Roman]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 30 Giugno 1900, Anno IV, Nr. 12, fq. 4-5.*
Autori i përgjigjet kritikës së prof. Luigji Çeçi (shih Nr. 211). Në këtë letër Sh. mbron edhe një herë pikëpamjen e vet në lidhje me lashtësinë e pellazgjishtes (shih edhe Nr. 185, 195).
225. — TRRANK SPIRO BËG (Pseud. i *Faik Konicës*): Abëtari i gjuhës shqipe. — *ALBANIA, Bruxelles, 1900, Viti IV, Nr. 6, fq. 114-115.*
A. shprehet në favor të alfabetit të shoq. "Bashkimi". Vetëm për disa shkronja, të cilat i rreshton në këtë artikull, nuk asht dakord me "Bashkimin".
226. — T[RRANK] S[PIRO] (Pseud. i *Faik Konicës*): Dietari Max Müller. — *ALBANIA, Bruxelles, 1900, Viti IV, Nr. 10, fq. E, 43.*
Njoftohet vdekja e Maks Mylerit, profesor i Univer. të Oksfordit. Jepen edhe disa shënime biografike.
227. — T[RRANK] S[PIRO] (Pseud. i *Faik Konicës*): Disa perghighe. — *ALBANIA, Bruxelles, 1900, Viti IV, Nr. 8, fq. E, 9.*
Çeshtje ortografie. Si duhet shkruar atdhetar apo atëdhetar.
228. — TRRANG SPIROBEG (Pseud. i *Faik Konicës*): Mënnime permi artikullin e masyperm. — *ALBANIA, Bruxelles, 1900, Viti IV, Nr. 1, fq. 37-38.*
Çeshtje ortografie. A. nuk asht i mendimit që të shkruhet *ma, ta pa* pa apostrof, sikurse propozon M. Logoreci (shih Nr. 208), po me apostrof. Përsa i përket pohimit të Logorecit se fjalët me origjinë turk e nuk përdoren me nyjet *i, e, të*, Konicë çfaq dyshim.
229. — TRR[ANK] SP[IRO] (Pseud. i *Faik Konicës*): Mënnime permi artikullin e "At-
dhetarit të Kosovës". — *ALBANIA, Bruxelles, 1900, Viti IV, Nr. 4, fq. 84-86.*
Riprodhohen tre artikuj të shkruem nga tre autorë rreth artikullit të *Atdhetarit të Kosovës* (shih Nr. 202). Artikulli i parë nënshkruhet nga *Geg Postrippa* (Filip Shirc ka) i cili e porosit Atdh. e Kosovës "të mos ngutet me hedhe poshte aq lehte shoq. e "Bashkimit"; i dyti nënshkruhet nga *Nakdo Monici* (Ndoc Nikaj), i cili shkruen se A. K. "e shkapercej bregun e urtisë" dhe lëvdon qëllimin e mirë të Shoq. "Bashkimi"; i treti nënshkruhet nga *Dom G.*, i cili shprehet në favor të Atdh. të Kosovës dhe kundër alfabetit të Shoq. "Bashkimi".
230. — TR[ANK] S[PIRO] (Pseud. i *Faik Konicës*): Permi drejtshkrim a orthografie të gjuhës s'one. — *ALBANIA, Bruxelles, 1900 Viti IV, Nr. 6, fq. 120.*
Ftohen lexues dhe hashkëpunëtorë të kësaj reviste që të çfaqin mendimin e tyre rreth krijimit të një ortografie për të dy dialektet.
231. — T[RRANK] S[PIRO] (Pseud. i *Faik Konicës*): Permi fii artikull të shkumun. — *ALBANIA, Bruxelles, 1900, Viti IV, Nr. 8, fq. E, 7.*
Çeshtje ortografie: shkronja e dhe ë.
232. — TRUHELKA, Dr.ÇIRO: Les restes illyriens en Bosnie [Mbeturinat iliriane në Bosnje]. — *ALBANIA, Bruxelles, 1900, Viti IV, Nr. 10, fq. E, 45 — E, 48: Nr. 11, fq. E, 61 — E, 63.*
Botohet një pjesë nga konferenca që A. mbajti në Paris më 1900 në Kongresin Etnografik. Përmban ndër të tjera etimologji, toponime e antroponime.
233. — VARIA: Cattedra di lingua albanese [Katedër e gjuhës shqipe]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 31 Gennaio 1900, Anno IV, Nr. 2, fq. 9.*
Artikulli ban fjalë mbi heshtjen e qeverisë italiane kundrejt kërkesës së 200 mijë italo-shqiptarëve për çeljen e një katedre të gjuhës shqipe në Napoli.
234. — VARIA: Cattedra di Lingua e Letteratura Albanese nel R. Istituto Orientale in Napoli [Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe në Institutin Mbr. Oriental në Napoli]: *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Novembre 1900, Anno IV, Nr. 21 fq. 9.*

- Intervistë e ministrit italian të arësimit, Gallo, dhanë stu-
dentit Battista Groppa, në lidhje me katedrën e gjuhës dhe të le-
tërsisë shqipe në Inst. Mbr. Oriental të Napolit.
235. — VARIA : Cattedra di lingua albanese [Katedra e gjuhës shqipe]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Ottobre 1900, Anno IV, Nr. 19, fq. 9-10.*
Njoftohet se për vjetin shkollor 1900-1901 u muer vendimi që të hapet pranë Institutit Mbr. Oriental të Napolit një katedër për mësimin e gjuhës shqipe. Drejtimi i kësaj katedre i asht besue prof. Zef Skirçit.
236. — VARIA : Dizionario albanese [Fjalor shqip] — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Febbraio 1900, Anno IV, Nr. 3, fq. 9.*
Njoftohet se P.K. dei Koronei filloi botimin e fjalorit shqip-italisht. Deri tashti asht botue vetëm një fashikull me 50 faqe (shkronja A e B).
237. — VDEKJA e Gustav Meyerit. — *ALBANIA, Bruxelles, 1900, viti IV, Nr. 9, fq. E, 29.*
Njoftohet vdekja e albanologut të shquem Gustav Majer. Botohet edhe një fotografi. (shih edhe versionin frangjisht : "Mort de Gustav Meyer" fq. E, 30).
- 1901 -
238. — ALBANIA: Thémélim i iue chmimit te perviteshun. — *ALBANIA, Bruxelles, 10 korrik 1901, Vit V, Nr. 7, fq. 104-105.*
Njoftohet se markezi Gjijn Aladro-Kastrioti themeloi një çmim prej 1000 frangash me titullin "Çmimi Skanderbeg". Ky çmim do t'i jepet mot për mot atij që do të mundohet ma shumë për zburimin e gjuhës shqipe dhe përhapjen e mësimit të saj (shih edhe versionin frangjisht: "Fondation d'un Prix annuel", fq. 109-110).
239. ALI EFENDI (pseudonim): La questione del alfabeto albanese [Çeshtja e alfabetit të shqipes]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Novembre 1901, Anno V, Nr. 21, fq. 4-5.*
Shoq. e "Bashkimit", shkruen A., u themelue në Shkodër para dy vjetësh me iniciativën e qeverisë austriake. Kjo shoqni e përkrahun nga konsulli austriak Ippen — vijon artikulli — kërkon t'ua imponojë alfabetin e vet gjithë shkollave të Shqipnisë së Epërme. Ngritjen e shoq. "Agimi" kundër shoq. "Bashkimi" autori e gjen me vend.
240. — ASDREN (Pseud. i Aleksandër S. Drenova): Ce ku é ce kur émeri "Shecpetar". — *TOSKA, Minia (Misir), 1 Tetuer 1901, Mot i I, Nr. 1, fq. 6-8.*
Në kundërshtim me tezat e S. Frashërit dhe të G. Majerit, autori mendon se zanafilla e fjalës "shqiptar" duhet kërkuë te legjenda e Pirros. A. Për të mbështetur tezën e vet sjell një varg citatesh e argumentesh të marrun nga autorët e vjetër grekë.
241. — ATDHËTARI I KOSOVES (Pseud. i Mati Logorecit): Vreimë mi drëjtëshkrim. — *ALBANIA, Bruxelles, 1901 Viti V, Nr. 2, fq. 23-24.*
Çeshtje ortografie. E-ja (e shurdhët) në gegënishtet. Autori vren se gegënishtja ë-n që sot nuk e ka, dikur e ka pasë. Shtron nevojën e futjes përsëri të ë-s në gegënishtet.
242. — ATDHËTARI I KOSOVES (Pseud. i Mati Logorecit): Rruga é Bashkimit. — *ALBANIA, Bruxelles, 1901, Vit'i V, Nr. 3, fq. 34.*
Për të mirën e përbashkët, autori fton gjithë bashkatdhetarët që të pranojnë alfabetin e "Bashkimit".
243. — BIB TOSKA (Pseud. i Milo Duçit): Kombiar a kombetar? — *ALBANIA, Bruxelles 25 gusht 1901, Viti V, Nr. 8, fq. 120.*
Çeshtje ortografie. Në lidhje me diskutimin e hapun, autori mendon se kjo fjalë duhet të përdoret ose me gjindore plus mbrapshatesën "tar", pra: i kombit — kombittar ose vetëm me mbrap. "ar": kombetar (shih edhe Nr. 257).

244. — BIBLIOGRAPHIE. — ALBANIA, *Bruzelles*, 25 gusht 1901, Viti V, Nr. 8, fq. 127.
Njoftohet se Dr. Holger Pedersen ka botue një "essai" (sprovë) mbi disa probleme të sintaksës irlandeze. Për ilustrim albanologu i shquem i Kopenhagës ka ba disa krahasime me atë të shqipes. Ma poshtë, shkruhet, Pedersen i shënon kalimthi se pjesëza *dot s'ka* asgja të përbashkët me *do të* të futurit të shqipes. — Njoftohet gjithashtu se Dr. Albert Tumb (Thumb), i Universitetit të Friburgut, ka botue në një revistë gjermane një studim interesant mbi Gustav Majerin.
245. — GUSTAF MAJER. — KALENDAR I KOMBIAR. *Sofje*, 1901, *mot' i pestë*, fq. 32.
Jepet një skicë-biografike e shkurtërën si dhe një fotografi e Gustav Majerit. (Shkrue me alf. e Stambollit).
246. — K[ONICA], F[AIK]: Fjale te ra e te nevojshme ne ghuhe shqip. — ALBANIA, *Bruzelles*, 1901, *viti V, Nr. 2*, fq. 27-28
Botohen 47 fjalë të reja shqipe (që i ka ose i përdor kjo e përkohëshme). Fjalët jepen me përkthimin frangjisht dhe turqisht dhe janë kryesisht të sferës ushtarake, administrative, politike e diplomatike.
247. — KONITZA, Fk BEJ: Shoceria kombetarë e Borgo-ëritsos. Sheptaret n'Austrie — ALBANIA, *Bruzelles* 31 Mij 1901, Viti V, Nr. 5, fq. 66-67.
Shkrue se me 8 prill 1901 në Borgo Erico u mbledh një kuvend për t'u marrë vesh për zhvillimin dhe përparimin e gjuhës shqipe. Në këtë kuvend si kryetar u zgjodh: z. Pal Paetani — Lpibichich, perkryetar: Dom Kristo Stieпка, shkrimtar (sekretar): z. Mattéo Markuchi-Kristich. Shpallen edhe vendimet e këtij kuvendi. Ma poshtë në një shënim Konica shkruen se fjalën "perandorar" e ka krijuë Kristoforidhi. Fjala "bashkëpunëtor" neologjizëm i përdorun në këtë organ, ka këtë kuptim: "ata që mbli-dhen dhe punojnë bashkë në një gazetë" (shih edhe Nr. 255, 256).
248. — LA TOPOGRAPHIE des campagnes de Scanderbeg contre les Turcs [Topografia e fushatave të Skanderbeut kundër turqëve]. — ALBANIA, *Bruzelles*, 10 korrik 1901, Viti V, Nr. 7, fq. 105-108; Nr. 9, fq. 139-141.
Jepet përshkrimi i 17 toponimeve (qendra vendesh ku Skanderbeu zhvilloi fushatat e tija luftarake kundër turqëve).
249. — LKENI I HASIT (Pseud. i Shtjefen Gjecovit): Shtjellim' i t'nyrnévë. — ALBANIA, *Bruzelles*, 1901, Viti V, Nr. 2, fq. 28-29.
Botohen 1: i hqip dhe latinisht emnat e 18 ngjyrave.
250. — MBE 1865 një shqiptar i flaktë, si edhe nga vjershat' e tij duketë, thoshte. — KALENDAR I KOMBIAR. *Sofje*, 1901, *mot' i pestë*, fq. 74-76.
Në këtë artikull bahet fjalë edhe për nevojën e themelimit të një alfabeti të përbashkët të shqipes. (Shkrue me alf. e Stambollit).
251. — PASHMOKDO (Pseudonim): Propaganda e ghuhes kombetarë (Létre nga Gégenia) — ALBANIA, *Bruzelles*, 1901, Viti V, Nr. 3, fq. 42.
U bahet një kritikë atyne shqiptarëve që mësojnë gjuhët e hueja e përbuzin gjuhën shqipe.
252. — SHKOLLE Shcipe ne Dallmatsi. — ALBANIA, *Bruzelles* 15 shtator 1901. Viti V, Nr. 9, fq. 135.
Nga Zara shkruen se në Borgo Erico do të hapet një shkollë krejt shqipe e kombëtare. Mësimet pritet të fillojnë këtë vjeshtë.
253. — SHTJËRTIME
Objekte të këtij artikulli janë: *ënriz* të thjeshtë dhe *ënriz t'urjisun*. Këta të fundit janë të mirëfilltësi gjylpan (ngul pen), *pasqyrë*, *rrethqyrë*, *lartqyrë* (kqyr pas, rreth, lart) dhe të rrjedhur me mbrapshatesat: *-i, -eni, -esi, -es, -ur, a -tur, ar, -tar, -ak, -tuk, -sur, -oji, -nazj, -us, -ojis, -es, -mit a -nit, -më*.
254. — SOCIETA "Dituria,, [Shoqnia "Dituria,,]. — LA NAZIONE ALBANESE *Pa-l-lagorio (Catanzaro) Italia*, 15 Maggio 1901, Anno V, Nr. 9 fq. 5-6
Botohet edhe rregullorja e kësaj shoqnie.
255. — STORIA e letteratura [Histori e letersi]. — LA NAZIONE ALBANESE, *Pa-l-lagorio (Catanzaro) Italia*, 31 Marzo 1901, Anno V, Nr. 6, fq. 5-6.
Në letërën që një shqiptar i ka dërgue A. Lorekjos, thuhet; ndër të tjera, se fjalët *bashkëpunëtor* (collaboratore), *perandorar* (imperiale), *gëlim* (volume), etj. janë krijuë nga "Albania" e F. Konicës kundër rregullave gramatikore të gjuhës shqipe (shih

edhe Nr. 247). Po në këtë artikull jepen disa të dhana biografike mbi Ed. Shnajderin, për të cilin shkruhet se asht autor i shumë veprave dhe artikujve të botueme nëpër gazeta e revista të Europës e të Turqisë për gjuhën dhe popullin shqiptar. Ma poshtë thuhet se Ed. Shnajderi, si i huej që asht, përsa i përket disa studimeve të tija etimologjike, ka ra në mjaft gabime. Në të tilla gabime përfundon artikulli, ka ra edhe J. De Rada.

256. — TR[ANK] SP[ROBEG] (Pseud. i Faik Konicës): Polenta edhe ghuhesia. — *ALBANIA Bruxelles 20 cersher 1901. Viti V, Nr. 6, fq. 86-87.*

Polcmikë me një artikull të botuem në "La Nazione Albanese" A. shkruen se fjalën "perandorar" e krijoi dhe e përdori i pari Nelko Kristoforidhi në përkthimin shqip të Ungjillevë dhe në drsh. e fjalorit; mbas Kr. më 1878 e përdori edhe Ogyst Dozon (August Dozon). Fjalën "bashkëpunëtor" e përdori Anastas Kullurioti në "Abavatar arberor", 1882, fq. 142. Kështu që fjala "bashkëpunonj" nuk asht gabim (frangj. "col-laborer", nga lat. "cum" e "laborare"; greq. "synérgazomai", gjerm. "mit-arbeiten"). (shih edhe Nr. 247, 255).

257. — TR[ANK] SP[ROBEG] (Pseud. i Faik Konicës): Në cheshtië ghuhesie. Kombiar a Kombetar? — *ALBANIA Bruxelles 1901 Viti V, Nr. 6, fq. 87-90.*

Botohet letra e L. Skendos me anën e të cilës ai kundërshton vërejtjen e *Albania-s*, simbas të cilës trajta *kombiar* (Shih Kalendar *Kombiar*) asht e gabueme. Lumo Skendo orvatet të provojë se trajta ma e drejtë asht *kombiar*. F. Konica nga ana e vet ngul kambë për trajtën *kombëtar* (shih edhe Nr. 243, 335).

258. — UN CONGRESSO Albanese [Një Kongres Shqiptar]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Maggio 1901, Anno V, Nr. 9, fq. 7.*

Bahet e ditun se prej datës 21-24 prill 1901, u mbajt në Napoli një kuvend shqiptarësh, në të cilin u rrahën edhe cheshtje të gjuhësisë. Ma poshtë thuhet se z. Kozmo Serembe, n'emën të Shoq. "Shqipnia e Re" (Gjovine Albania) ka shkruar, në lidhje me alfabetin, se Shqiptarët e lindjes nuk janë të detyruem me pranue si gjuhë kombëtare dialektet italo-shqiptare. Një alfabet kombëtar — vijon Serembe — egziston që prej vjetit 1879 dhe ky asht alfabeti i Stambollit, i përdorun tashma në gjithë Shqipninë. Njëqoftëse, përfundon K. Serembe, për çudi si alfabet kombëtar do të caktohet njeni nga të shumtë që mbine në Itali, atëherë duhet të pranohet alfabeti i De Radës si ma i vjetri e ma i miri.

259. — UNE conférence de M. Hasdeu sur l'origine des Albanais [Një konferencë e Z. Hasdeu mbi origjinën e Shqiptarëve]. — *ALBANIA, Bruxelles 15 Dhietor 1901, Viti V, Nr. 12, fq. 195-196.*

Profesori i Universitetit të Bukureshtit, Z. Bogdan P. Hasdeu, anëtar i Akademisë rumune, shkruhet në këtë artikull, zhvilloi në seancën e Akademisë të datës 25 maj 1901, idetë e tija mbi origjinën e popullit shqiptar. Autorët që z. Hasdeu ka konsultue janë këta: Askoli, Benlëv, Biondeli, Blau, Kamarda, Difenbah, Dozon, Hahn, Jarnik, Katansiq (Istri adcolarum geographia vetus; Budae, 1827, t. II, p. 287), Kullurioti, G. Majer, Miklosiq, Morati, Nikokles, dy De Radat, Rajnhold, Réti, H. Shuhardt, Spata, Shtier, Shtrangfortd, Tomashek, Vreto, Ksilander e Zeuss.

Z. Hasdeu mbroi tezën e origjinës iliriane të Shqiptarëve. Për të mbështetur tezën e vet H. Lexoi një listë të gjatë fjalësh shqipe që gjinden edhe në gjuhën e fshatarëve rumunë, si p.sh. *buza, qafa, mal, bukur, vatra, mirë, vapë*, etj. H. ven në dukje se afria leksikore shqiptaro — rumune asht dytësore (sekondare) në krabasim me afrinë gramatikore.

260. — VARIA: La propaganda austriaca per l'Albania [Propaganda austriake për Shqipni]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Maggio 1901 Anno V, Nr. 9, fq. 10.*

Nga Zara (Dalmaci) njoftohet se këshilli krahinor shkolloi vendosi të ngrihet një katedër për mësimin e gjuhës shqipe në Institutin magjstral [pedagogjik] të Borgo Ericos.

261. — VDEKJET e motit 1900. — *KALENDARI KOMBIAR, Sofje 1901, moti pestë, fq. 26-27.*
Njoftohet se me 20 janar 1900 vdiq në Paris Lui Benlëv (Louis Benloew), me origjinë çifute, i lindur në Erfurt më 1818. L. Benlëv njihet me këto vepra: *Avullë e gjuhës shqipe; Greqia para grekëve* dhe *Ritmi e ritmi në ojershat epike shqipe*. Botohet edhe një fotografi e Benlëvit. (Shkruar me alf. e Stambollit).
- 1902 -
262. — BIB TOSKA (Pseud. i *Milo Duçit*): Cheshjtj'ë abëcëse Sheqipë. — *TOSKA, Minia (Misir), mars 1902, Mot I, Nr. 3, fq. 20-21.*
Artikull polemik kundër *Abë Ebrdi* ((pseudonim) për cheshjtje të alfabetit të shqipes (shih Nr. 239).
263. — BIB TOSKA (Pseud. i *Milo Duçit*): Mbledhja lëtrësorë Shkolers. — *TOSKA, Minia (Misir), Jun 1902, Mot I, Nr. 6, fq. 41-42.*
Në lidhje me rezultatet e arrituna në mbledhjen e Shoq. "Bashkimi" në Shkodër për cheshjtje të alfabetit të shqipes, autori bashkohet me qëndrimin e mbajtura nga Primn (Pread) Doçi, Abat i Mirditës.
264. — DE RADA, G. : Prolusione all'apertura della Scuola albanese nel Collegio di Sant' Adriano [Proluzionë në çeljen e Shkollës arbëneshe në Kolegjin e Shën Adrianit]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Novembre 1902, Anno VI, Nr. 21, fq. 3-4.*
Ligjeratë me rastin e çeljes së shkollës.
265. — DEG'Ë SHOQËRISË "Dituria" në Kostancë. — *DRITA, Sofia, 22 korrik 1902, Viti I, Nr. 11, fq. 4.*
Njoftohet se më 29 qershor 1902 u themelua në Kostancë të Rumanisë *Dëgja e Shoqërisë "Dituria"*. (Shkruar me alf. e Stambollit)
266. — DUÇI, MILO: Cheshjtj'ë abëcëse. — *TOSKA, Minia (Misir) Prill 1902, Mot I, Nr. 4, fq. 29-30.*
Polemikë për cheshjtje të alfabetit me "Dëshirën" e Sofjes.
267. — F⁺ (Pseudonim): Të ruajturitë gjuhësë. — *DRITA, Sofia 18/31 mars 1902, Viti I, Nr. 9, fq. 2.*
Në këtë artikull bahet fjalë për nevojën e përmirimit të gjuhës shqipe nga barbarizmat si dhe për disa cheshjtje të ortografisë, të dialekteve dhe të gjuhës letrare të përbashkët të shqipes. (Shkruar me alf. e Stambollit).
268.] — G.G. Nostre corrispondenze [Korrespondencat tona]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 31 Maggio 1902, Anno VI, Nr. 10, fq. 4-5.*
Njoftohet se kongresi gjuhësor shqiptar i mbledhur në Shkodër me iniciativën e Shoq. "Bashkimi" për të ra në marrëveshje me cheshjtjen e alfabetit, i ndërpreu bisedimet në mënyrë të papritun. Mendohej që së shpejti të bahet edhe një mbledhje tjetër për punë të alfabetit.
269.] — GURACUCCHI, LUIGI: Due Colonie Albanesi in Italia finora sconosciute [Dy Koloni Arbëneshe në Itali deri sot të panjohuna]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia 15 Giugno 1902, Anno VI, Nr. 11, fq. 5-6.*
Ndër të tjera, autori shkruan mbi nevojën e një pune serioze shkencore në lamën e historisë së gjuhës shqipe tue u mbështetur në rezultatet e kërkimeve të gjuhësisë së krahasimeve.
270.] — KONITZA, FAIK BE: Abëtare Sheip — shtëti e tanishme i Cheshhties (État actuel de la question) — *ALBANIA, Bruxelles, Kalendrier 1902, Viti VI Nr. 1, fq. 19-22.*
Tue analizuar alfabetet e derisotëm, autori ban këto vërejtje: për alfabetin e Autorëve të Vjetër të Veriut thotë se ka dy të meta a) ka disa shkronja që nuk gjenden në shtypshkronjat, b) s'asht i mjaftë për toskënishten. Për alfabetin e Stambollit, shkruen se ka shumë të meta (përzimje shkronjash latine, sillave e greke) pra i papërshtatshëm për t'u pranuar si alfabet i mbarë shqipes. Alfabetin e "Bashkimit", megjithëse nuk asht pa të meta, e pël-

- qen ma tepër sepse me këtë alfabet mund të shtypen libra në çdo shtypshkronjë. Këtu A. përpiket të vejë në dukje epërsinë e alfabetit të "Bashkimit" ndaj atij të "Stambollit".
271. — K[ONICA], F[AIK]: Terbimi i zaptiévé — ALBANIA, Bruxelles, Cershuar 1902, Viti VI, Nr. 5, fq. 152-154.
Polemikë me red. e gazetës DRITA të Sofjes. Ma poshtë jep edhe një pasqyrë të jetëshkrimit të vet.
272. — LIBERSHKRIM [Bibliografi]. — ALBANIA, Bruxelles, mars 1902, Viti VI, Nr. 3 fq. 68.
Njoftohet se Dr. Holger Pedersen, botoi në një të përkohëshme gjermane një artikull, në të cilin gjykon fletoret shqipe që dolën më 1896-97-98.
273. — LIBRESHKRONJË [Bibliografi]. — DRITA, Sofia 29 Gusht 1902, Viti I, Nr. 15, fq. 4.
Njoftohet se doli në dritë vepra "L'Albania e l'opera di Girolamo De Rada" në gjuhën italishte, pregatitë prej Z. Dr. Mikel Markjanò (Michele Marchianò). Në këtë libër prej ma se 400 faqesh, përmbledhen gjithë shkrimet e De Radës. Porositen që ta blejnë gjithë shqiptarët që interesohen për çështjen shqiptare dhe gjuhën shqipe. (Shkrue me alf. e Stambollit)
274. — LORECCHIO, ANSELMO: L'alfabeto Albanese [Alfabeti shqip]. — LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Gennaio 1902, Anno VI, Nr. 1, fq. 2-3.
Shumë diskutime dhe shumë kohë po humbet për punë të alfabetit të shqipes, shkruen A., kurse në të vërtetë alfabeti kombëtar shqiptar egziston dhe ky asht alfabeti i Stambollit, me të cilin janë shkruar shumë vepra, libra shkollore, etj. të përhapuna në gjithë Shqipërinë. Krijimin në Shkodër të Shoq. "Bashkimi", A. e quen si një manevër të taktikës së qeverisë austriake për të mbërritur synimeve të veta politike.
275. — MAKS Müller. — KALENDARI KOMBIAR, Sofje, 1902, mot'i gjashtë, fq. 28.
Njoftohet vdekja nga fundi i vjetit 1900 e orientalistit Maks Myler (i Oksfordit). Jepen edhe pak të dhana biografike (Shkrue me alf. e Stambollit)
276. — N.M.: Shocniia e Bashkimit. — ALBANIA, Bruxelles, Mars, 1902, Viti VI, Nr. 3, fq. 58-60.
Qëllimi që i ka vu vetes shoq. e "Bashkimit" — shkruhet në këtë artikull — asht të përhapurit dhe zhvillimi i gjuhës shqipe, tue ruejtë secili dialekt fytyrën e vet. Gegët e toskët le të hetojnë deri në skutat ma të largëta të vendit për të nxjerrë në dritë thesarin e gjuhës shqipe, e nëse toskës apo gegës i duhen fjalë që nuk i ka në dialekt të vet, të mos i kërkojë në gjuhët e hueja, po nga dialekti tjetër. Në këtë mënyrë dialektet tue i marrë fjalë njena tjetrës shporrin fjalët e hueja dhe i çelin rrugën bashkimit të tyne. Italo-Albaneze n'Itali. — DRITA, Sofia, 7 [20 vjeshtë e 3-të, 1902, Viti I, Nr. 17, fq. 4.
Njoftohet se në San Adriano (Itali) u çel një shkollë italo-arbëneshe. (Shkrue me alf. e Stambollit).
278. — NOSTRE Corrispondenze [Korrespondencat tona]. — LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Ottobre 1902, Anno VI, Nr. 19, fq. 5.
Bahet fjalë për mbledhjen e prelatëve të Shkodrës, të cilët u ndanë në dy grupe për çështje të alfabetit të shqipes. Përsa i përket alfabetit të Nd. Mjedës, në këtë artikull thuhet se ky sistem nuk asht tjetër veçse një *mutatis mutandis* i atij të Brugmanit, Majerit, etj. i përbamë prej 16 shenjash diakritike. Në këtë artikull flitet kundër alfabetit të Nd. Mjedës.
279. — PEDERSEN, Dr. H.: Ne lëtre e Z... — ALBANIA, London, Shtatuar 1902, Viti VI, Nr. 8, fq. 202.
Në këtë letër H. Pedersen i parashtrohet pikëpamjet e tija në lidhje me alfabetin e shqipes, të cilat përmbledhtazi janë këto: pëlqen librat e botueme nga shoq. "Bashkimi", po si alfabet pëlqen ma fort atë të "Albania"-s. Mendon se nuk do të jetë e largët koha që edhe shqiptarët të kenë një sistem të vetëm të alfabetit. Asht i bindun së alfabeti që do të zgjedhin shqiptarët nuk do të jetë as grek, as sillav, as arab, po latin (jo italian). Vështirësi do të ndeshen nëse disa tinguj (si *dh, sh, th*, etj.) do të përfaqësohen

nga një apo dy shkronja. Në këtë pikë pëlqen ma fort alfabetin e G. Majerit, nëqoftëse i hiqen karakteret greke. Po këtë punë bani edhe Ndre Mjeda, i cili e solli alfabetin e vet përpara kongresit të orientalistëve në Hamburg, ku edhe u pëlqye.

Sidoqoftë, përfundon P. një sistemë me shkronja binjake mund të përmirësohet deri në atë shkallë sa të mund të kënaqen të dy palët.

280. — TR[ANK] SP[IROBEG] (Pseud. i Faik Konicës): Ghuha Sheip në rézik. *ALBANIA, Bruxelles, prill-maj, 1902, Viti VI, Nr. 4, fq. 85-88.*

Artikull polemik kundër një artikulli të gazetës "Drita" të Sofjes. Ma poshtë A. prek çështje të fonetikës (kuantitetin e zanoreve të shqipes: të gjata e të shkurta) si dhe të ortografisë. Përsa i përket gramatikës shqipe, A. shkruen se kjo do të hartohet mbasi të themelohet letërsia shqipe, ashtu si edhe në Francë, letërsia e së cilës u themelue në mesin e shekullit XIV, kurse gramatika u sigurue mirë vetëm në mesin e shekullit XVII.

281. — TRIFONIO, GUIDERA: L'alfabeto albanese [Alfabeti shqip]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Maggio 1902, Anno VI, Nr. 9, fq. 4-5.*

Alfabetet e shumtë që mbine shkruen A., e kanë pengue punën që të vendoset njëherë e mirë për një alfabet kombëtar. Gjuha shqipe — vijon A., në të vërtetë e ka një alfabet kombëtar, të hartuem me baza shkencore dhe me një histori të gjatë. Origjina e këtij alfabeti, i cili përbahet prej 38 shkronjash, datohet që nga shekulli i V dhe asht formue nga linguisti armen Mesrop Masdoty. Ma poshtë, tue u marrë me evolucionin e këtij alfabeti, A. thotë se ky alfabet u kthye përsëri shqipes nëpërmjet të alfabetit të Kamardës, i përhamë edhe ky prej 38 shkronjash fonetikiisht i njajtë me alfabetin kombëtar (të Masdotyt) me ndryshime vetëm në grafi, etj.

282. — VARIA: Girolamo De Rada. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 30 Settembre 1902, Anno VI, Nr. 18,*

Ky numër i kushtohet figurës së Jeronim De Radës. Në faqen e parë botohet një fac-simile e medaljes së madhe të argjentë dhe e diplomës në pergamen që u dha De Radës nga Gjin Aladro Kastrioti.

283. — VARIA: Ortografia della lingua albanese [Ortografia e gjuhës shqipe]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 31 Luglio 1902, Anno VI, Nr. 14, fq. 9-10.*

"Ortografia e Gjuhës Shqipe" asht titulli i një broshure që u botue në Venedik nga D. Gaspër Jakova. I bahet një recension i shkurtën, po me rezervë. Gjykimi nëse G. Jakova ia ka dalë mb'anë apo jo me këtë broshurë, do të jepet mbasi vepërza të jetë lexue e studjue nga shkrintarë e njerëz të ditun.

284. — VAUGELAS (Pseudonim): Mendime Ghuësië. — *ALBANIA, Bruxelles, mars 1902, Viti VI, Nr. 3, fq. 67; Nr. 4, fa. 93-94; Nr. 5 fq. 150.*

A. shkruen për ortografinë e disa fjalëve shqipe.

— 1903 —

285. — ABECEJA Shqip. — *DRITA, Sofje 21 vjesh'te tretë, 1903, Viti II, Nr. 33, fq. 4.*

Jepet një pasqyrë e alfabetit të shqipes (alfa. i shoq. së Stambollit) prej 37 shkronjash teke me versionin frangjisht turqisht e greqisht. Ribotohet në disa numra të kësaj gazete.

286. — ALBANIA: Vdekja e Prof. Emile Legrand. — *ALBANIA, London, Shtator 1903, Viti VII Nr. 9, fq. 133-34.*

Njoftohet vdekja e E. Legrandit. Jepet një pasqyrë e shkurtën me shënime biografike si dhe një fotografi e E. Legrandit, (Shih edhe versionin frangjisht, në fq. 187).

287. — [BIBLIOGRAFI]: "Origine des Récits légendaires des premiers âges de Rome" par EDOUARD SCHNEIDER. Paris 1903". — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 30 Novembre 1903, Anno VII, Nr. 22, fq. 5-6.*

- Recension mbi librin e Ingj. Ed. Shnajder botue tash së fundit; i cili ban fjalë mbi ripërtrimjen e historisë së kohëve të herëshme të njerëzimit. Në këtë libër Shnajderi mbi 20 fjalë *arkeo-pellazgjike* (14 emna njerëzish, 3 kodrash, 2 popujsh dhe 1 krahine) i zbërthen etimologjikisht me ndihmën e gjuhës shqipe (simbas teorisë pellazgjike).
288. — BILOTTA, BERNARDO: Note filologiche [Shënime filologjike]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 31 Luglio 1903, Anno VII, Nr. 14, fq. 5-6.*
Jep disa etimologji (simbas teorisë pellazgjike)
289. — ÉTUDES savantes et articles concernant l'Albanie [Studime ditunore dhe artikuj që i përkasin Shqipnisë]. — *ALBANIA, London kalenduar 1903, Viti VII, Nr. 1, fq. 16.*
Për gjuhësi:
1. *Über griechische Elemente in den alten Barbarensprachen und im Albanesischen*, nga Prof. Dr. Thumb, i Marburgut.
290. — FIALE shecipë é Bishtera sillave. — *ALBANIA, London, korrik 1903, Viti VII, Nr. 7, fq. 104.*
Shkruhet se mbrapashtesa *-ka* (shih shqiptarka, etj.) asht sillave dhe nuk duhet përdorun.
291. — GIROLAMO DE RADA. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Marzo 1903, Anno VII, Nr. 5, fq. 3-7.*
Nekrologji për vdekjen e J. De Radës (28. II.1903)
292. — GHUHA shecip n'Austrie. — *ALBANIA, London, Shtator 1903, Viti VII, Nr. 9, fq. 131-132.*
Njoftohet se dy vjet ma parë në Borgo Erico afër Zarës (Dalmaci) u hap një shkollë e gjuhës shqipe nën drejtimin e At Pashko Bardhit. Numri i nxanësve (djem e vajza) që ndjekin këtë shkollë këtë vjet ka mbërritur në 120 veta. (Shih edhe versionin frangjisht: *L'enseignement de la langue albanaise en Autriche*, fq. 119).
293. — GHUHA shecipë ne Viene. — *ALBANIA, London korrik 1903, Viti VII, Nr. 7, fq. 103.*
Njoftohet se në Vjenë u hap një degë e gjuhës shqipe me drejtues Z. Gjergj Pekmezin.
294. — GJUHA shqip në Borgo Erizzo. — *DRITA, Sofia 22 Dimeror 1903, Viti II, Nr. 35, fq. 3.*
Njoftohet se në Borgo Erico (Dalmaci) që prej dy vjetësh asht lejuë mësimi i gjuhës shqipe. Drejtor i kësaj shkolle asht Pashko Bardhi, nga Shkodra (Shkrue me alf. e Stambollit)
295. — GJUHA shqip me gjuhët e tjera. — *DRITA, Sofia 5/15 Dimeror 1903, Viti II, Nr. 34, fq. 1-2; Nr. 35, fq. 3.*
Bahet një përmbledhje e shkurtën e historisë së gjuhëve botnore me një pasqyrë klasifikuese të këtyne gjuhëve, në krye të të cilëve qëndron grupi indoeuropian. Në lidhje me origjinën e fjalës *Arbër*, në këtë artikull thuhet se kjo asht e përbame prej dy fjalësh shqipe: *ar* dhe *bërës* që do të thotë ai që punon arën, bujk. Trajta e tjera si *alban*, *arvanit*, *arnaut* cilësohen si shtrembënime të fjalës *arbër*. Në përgjithësi kërkohet të vihet në dukje epërsia e pellazgëve si paraardhës të shumë popujve të Europës tue përfundue se e vetmja mbasardhëse e pellazgjishtes sot asht gjuha shqipe. (Shkrue me alf. e Stambollit)
296. — GJUHA shqip në Vjenë. — *DRITA, Sofia, 22 vjesht'e dytë 1903, Viti II, Nr. 31, fq. 3.*
Njoftohet se në shkollën e gjuhëve të Lindjes në Vjenë, u vu edhe mësimi i gjuhës shqipe. Zotni Gjergj Pekmezi, nga Ohri, i cili ka marrë diplomën e doktorit në filologji në Universitet të Vjenës, asht caktue drejtor për mësimin e shqipes. Ma poshtë thuhet se gjuha shqipe duhet të mësohet edhe në Bukuresht e në Athinë. (Shkrue me alf. e Stambollit).
297. — K[OLONJA], SH[AHIN]: Shkronjëtorja a gramatika shqip. — *DRITA, Sofia, 22 Dimëror 1903, Viti II, Nr. 35, fq. 1-3; Nr. 36, fq. 3-4; Nr. 37, fq. 2.*

Autori jep një sprovë të gramatikës së gjuhës shqipe. Mbase shpjegon se ç'është gramatika dhe pse duhet studjue, hyn në parafrazën e landës. Trajton kategoritë leksiko-gramatikore të shqipes (emna, mbiemna, folje, ndajfolje, etj. gjininë, numrin, rrasat, etj.). Terminologjinë shqipe të kësaj gramatike, autori e jep në përkthimin latinisht, greqisht e nga ndonjëherë edhe në arabo-turqisht tue e krahasue shpesh herë me variantet analoge të gramatikës së S. Frashërit dhe të autorëve të Veriut. Në numrat e mavonshëm punimi vazhdon me titullin e ndryshuem: *Rregulla shkronjësorake të gjuhës shqip* — shih Nr. 348. (Shkrue me alf. e Stambollit)

298. — K[OLONJA]; SH[AHIN]: Shkrimi, këndimi, abetare e gjuhës shqip. — DRITA, Sofia, 22 vjeshtë e dytë. 1903, Viti II, Nr. 31, fq. 1-2; Nr. 32, fq. 1-2; Nr. 33, fq. 1-3.

Autori paraqet një pasqyrë përmbledhëse të lindjes dhe të zhvillimit të gjuhëve të foluna e të shkrueme që nga fillimet e deri në ditët tona. Ma poshtë, tue iu referue gjuhës shqipe, A. kujton veçan veprimtarinë e Rilindasve, sidomos atë të Kristoforidhit, për përhapjen dhe zhvillimin e gjuhës shqipe. Prek edhe ceshtjen e alfabetit. (Shkrue me alf. e Stambollit).

299. — K[ONICA], F[AIK]: Girolamo De Rada. — ALBANIA, London, Prill 1903, Viti VII, Nr. 4, fq. 51-52.

Nekrologji për vdekjen e J. De Radës (Një njoftim i shkurtën jepet edhe në Nr. 3, fq. 41 të kësaj reviste).

300. — K[ONICA], F[AIK]: Z. Gaspar Jakoves. Lëtre e chilun. — ALBANIA, London, Friar 1903, Viti VII, Nr. 2, fq. 24.

A. e kritikon ndër të tjera G. Jakovën për turqizmat e tepërue me që përdor në shkrimet e tija.

301. — [KONICA FAIK]: Mendimë permi në liber te ri: — "Hiejetorë istori, më urata te thena edhe mërimështerake kora, per te paren dhe te dyten rishëte te shkollëse, prej P.H.H.N. Shtypure prej Deges se shocerse "Dituria" nde Konstantse. Sofje 1903. — ALBANIA, London, Cërshor, 1903, Viti VII, Nr. 6, fq. 94-96.

Recension. Tue gjykue veprën e P.H.H.N. [Papa Kristo Negovanit], Konica shkruen se autori ia ka mbërritun qëllimit që të mos përdor asnjë fjalë të huej. Për t'ia dalë kësaj, i asht dasht të fusë fjalë nga shqiptarët e Greqisë, në përgjithësi të panjo-huna, por që autori për t'u kuptue u ka vu poshtë shënimin e përkthimit në greqisht. Për shumë fjalë si *bot*, *u-shpermetme*, *mirherështonj*, *atëresë*, *lëmjak*, *beronjë*, *krjeprugëllonjës*, *përkufizonj*, *burkëzor*, etj. etj. Konica ban vërejtje të ndryshme: disa i pëlqen, disa i quen të gabueme ose të çpikuna, etj.

302. — NJË E SHKRUAR shqip më 1635. — KALENDARI KOMBIAR, Sofje 1903. *Mot'i shtatë*, fq. 33-40.

Bahet fjalë për Fjalorin e Frang Bardhit, për të cilin artikull-shkruesi thot se me këtë veper nis edhe shkrimi i gjuhës shqipe. Ribotohet parathania e Fjalorit, tue u pajisë me shënime shpjeguese per disa nga fjalët e rralla ose të vështira që hasen gjatë tekstit. (Shkrue me alf. e Stambollit)

303. — FEDERSEN; HOLGER: Kombet e vegjëlë dhe gjuhësija. — KALENDARI KOMBIAR, Sofje, 1903, *mot'i shtatë*, fq. 59-60.

Artikull i shkurtën shkruet posaçerisht per "Kalendarin". P. shkruen se gjuha shqipe, megjithëse asht e një kombi të vogël; për gjuhësinë europiane ka po atë randësi sa edhe e çdo kombi tjetër te madh. Si shembull P. kujton punimin voluminoz (prej afro 5000 faqesh) të prof. Brugmanit mbi gjuhët e Europës. Nga ky punim Brugmani botoi një vëllim 700 faqesh, në të cilin një vend te dukshem zen edhe gjuha shqipe. (Shkrue me alf. e Stambollit).

304. — SHENIME. — ALBANIA, London, Mai 1903, Viti VII, Nr. 5, fq. 27.

Pyetjes se nga ç'vend i Shqipnisë e ka rranjën De Rada, përgjigja asht se De Rada mund ta ketë origjinën e nga Radati o nga Radani, dy katunde krejt shqiptare në mes të Përmetit dhe të Konicës. Radani, shkruhet ma poshtë, ka ma tepër mundësi të jetë vendi i stërgjyshve të De Radës, mbasi edhe vetë poeti emnin e tij e shkruante Radanjë. Këto, përfundon artikulli, janë vetëm hipoteza.

305. — SHOQERI e re në Shkodrë. — *DRITA, Sofia, 17.I.1903, Viti II, Nr. 19, fq. 4.*
Njofto se në Shkodër, veç Shoq. "Bashkimi", u krijue edhe një shoqni e re, shoq. "Agimi", e cila sajoj edhe ajo një alfabet të ri. (Shkrue me alf. e Stambollit).
306. — TE GELLTITURIT é fialevé te ra. — *ALBANIA, London, Cershor 1903, Viti VII, Nr. 6, fq. 83-84.*
Në këtë artikull trajtohet problemi i asimilimit të fjalëve të hueja (ndërkombëtarizmave) në gjuhën shqipe dhe zavendësimi i barbarizmave me fjalë shqipe. Si shëmbull të një trajtimi të tillë. autori kujton artikullin e z. Gijom Apollinerë (Guillaume Apollinaire) të botuem në *L'Européen* me titull "Lufta e fjalëve frange në Gjermani".
307. — TH[RANK] SP[IROBEG] (Pseud. i Faik Konicës): Ghuhesia. — *ALBANIA, London, Gusht 1903, Viti VII, Nr. 8, fq. 125-128.*
Njoftime të përgjithëshme mbi gjuhësinë. Ka këta nëntituj: 1. Ç'është gjuhësia? 2. gjuha ndron pa pushuar, 3. kur dhe pse ndrojnë gjuhët? 4. Të ndarët e gjuhëve: a) gjuhët ndarëtoze (langues isolantes), b) gjuhët përmbledhëtoze (langues agglutinantes), c) gjuhët pësimtare (langues flexionelles).
308. — VARIA: Cattedra di lingua albanese [Katedër e gjuhës shqipe]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 30 Aprile 1903, Anno VII, Nr. 8, fq. 8.*
Njoftohet se në Akademinë Teresiana të Vjenës u çel një katedër e gjuhës shqipe, me prof. Dr. Pekmezi, nga Ohri.
309. — VAUGELAS (Pseudonim): Ndime per te fialuar shqip. Te vena re. — *ALBANIA, London, mars 1903, Viti VII, Nr. 3, fq. 38-40.*
Shkruen për nevojën e pasunimit të leksikut të shqipes. Korresponduesja e mbapashtesës fr. -able, lat. -abilis. gr. -tos (khs. admirable, mirabilis, etj). për shqipen mungon. Nga fjala rranjë shok: (lat. socius). A. rrjeshion një varg derivacionesh, një pjesë e të cilavet janë krijime të vetë autorit.
310. — VILLAGGI incendiati nel Vilajet di Monastir durante gli ultimi torbidi [Katunde të djeguna në Vilajetin e Manastirit gjatë turbullimeve të fundit]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Novembre 1903, Anno VII, Nr. 21, fq. 8.*
Përmban edhe toponime (emna katundesh të Manastirit; Kerzovës, Ohrit, Kosturit, Follorinës, Resnjes e Prespës).
- 1904 —
311. — A.D.: Giuramenti, voti, maledizioni Albanesi della Toscheria [Betime, urime mallkime shqipe të Toskënisë]. — *LA NUOVA ALBANIA, Napoli, 1 Gennaio 1904, Anno III, Nr. 1, fq. 4-5.*
Botohen në shqip 110 shprehje betimesh, urimesh, mallkimesh e sharresh të mbledhuna në Toskëni. (Nxjerrë nga koleksioni i A.D. II).
312. — ADAMIDI, Dr.: Aperçu général sur l'origine des Albanais et leur langue, lu à l'Institut Egyptien [Vështrim i përgjithshëm mbi origjinën e Shqiptarëve dhe gjuhën e tyre, lexue në Institutin Egjiptian]. — *BESA Le Caire Vjeshit I rë, 1904, Vit'i I-rë, Nr. 1, fq. 21-22; Nr. 2, fq. 33-34; Nr. 3, fq. 48-50. 1905, Nr. 4-5, fq. 72-73 vv.*
Ligjeratë mbi origjinën pellazgjike të popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij.
313. — ALBANIA: Problemi i shkrimit te ghuhes shqipë, i vene ne vent te vertete te tij. — *ALBANIA, London, 1904, Viti VIII, Nr. 12, fe. 222-224.*
Me qenë se alfabeti i "Bashkimit" i kaloi kufijt e Shkodrës dhe u pëlqye *lirisht e veriu* në Rumani, në Misir, në Itali, në Stamboll, në Selanik, në Elbasan e gjetiu, *Albania* shkruen se ndryshimet e vogla që ekzistojnë në disa shkronja të saja me ato të "Bashkimit", po i heq. Bashkimi i alfabeteve, vijon artikulli, nuk do të thotë edhe bashkimi i dialekteve.
Në fund çeken edhe disa çështje të ortografisë së të dy dialekteve të shqipes.
314. — AMICUS PATRIAE (pseudonim): Nostre corrispondenze [Korrespondencat tona]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia 30 Giugno 1904, Anno VIII, Nr. 12, fq. 6.*

Në një letër të ardhun prej Shkodre thuhet se monsinjor P. Guerini, argjipeshkëv i Shkodrës, dha një banket ku muerën pjesë shumë prelatë të ardhun nga rrethi i Shkodrës dhe i Durrësit. Qëllimi i vërtetë i kësaj mbledhjeje, shkruen A., ishte që të krijonin një bllok unik për rreth alfabetit të Nd. Mjedës dhe kundër alfabetit të "Bashkimit".

315. — ARGONDIZZA,

Prof. ANTONIO: L'Albania. Cenni storico-geografico-filologicie (*Continuazione N. 19, Anno II*). VII. Parte filologica [Shqipnia. Shënime historiko-gjeografiko-filologjike (vazhdim nga Nr. 19, Vjeti II). VII. Pjesa filologjike]. — *LA NUOVA ALBANIA, Napoli 1 Gennaio 1904, Anno III, Nr. 1, fq. 7-8; Nr. 3, fq. 5-6; Nr. 7, fq. 8, (cv)*.

Në pjesën filologjike, autori prek çështje të etimologjisë dhe të gjuhësisë krahasuese. Tue u mbështetë edhe nga një citat i Platonit (i cili ka shkruar për gjuhën greke: "Nëqoftëse ti nuk do të gjeish prejardhjen e fjalëve greke nga vetë idioma greke, atëherë këtë kërkoje tek barbarët, prej të cilëve grekët kanë marrë mjaft fjalë"), autori shumë fjalë të fondit grek i ndriçon me ndihmën e shqipes.

316. — BIBLIOGRAFIA:

"Ed. Schneider — La grotte de Corneto Tarquinia et ses inscriptions étrusques" — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia 31 Dicembre 1904, Anno VIII, Nr. 24, fq. 6*.

Recension. Studimin e sipërm: "Shpella e Korneto Tarkuinias dhe mbishkrimet e saj etruske" Ed. Shnajderi e ka botue në *Revue d'Europe et des Colonies*. Sikurse edhe në mjaft botime të tjera, edhe në këtë studim zbërthimin e mbishkrimeve etruske të gjetuna në këtë shpellë nga Maffei, në gjysmën e parë të shekullit XVIII, Shnajderi e ka ba me ndihmën e gjuhës shqipe.

317. — CASSIANI, FERDINANDO ALESS.:

La poesia albanese [Poezia shqipe]. — *LA NUOVA ALBANIA, Napoli 1 Gennaio 1904, Anno III, Nr. 1, fq. 5-6*.

De Rada, shkruen autori ndër të tjera, në studimin e tij mbi gjuhën shqipe, ka tregue kuartë prejardhjen e shqiptarëve nga pellazgët e lashtë. Edhe Malte-Brun, G. de Hahn, Qezare Kantù (Cesare Cantù) e Dora D'Istria e konfirmojnë këtë gjykim të poetit të madh të Makjas, përfundon A.

318. — CIARLA, GUGLIELMO:

Girolamo De Rada. — *PRO-ALBANIA, Campobasso, Aprile 1904, Numero unico, fq. 6*.

Riprodhim i artikullit të botuem në *La Nazione Albanese* Nr. 5, 1 mars 1901, me rastin e vdekjes së poetit.

319. — CONTE Vladany

(Pseud. i *Gaspër Jakova-Merturi*): I nostri diritti [Të drejtat tona]. — *LAIMTARI I SHCYPENIES (L'Araldo d'Albania), Frascati (Roma), 1 nandenuer (1904) Vieta I, Nr. 4, fq. 1*.

Në shënimin I autori fjalën bulgar (ose bulkar) etimologjikisht e spjegon të ardhun nga fjala shqipe *bulk!* (bulkar=fshatar).

320. — CORREGGENDO

le bozze di stampa [Tue ndreqë bocat e shtypit]. — *PRO-ALBANIA, Campobasso Aprile 1904, numro unico, fq. 8*.

Përmban edhe toponime (vendbanimet e Shqiptarëve të Italisë).

321. — CRONACA

Balkanica (Notizie della quindicina [Kronikë ballkanike (Lajme të përdryjavëshme)]. — *LAIMTARI I SHCYPENIES (L'Araldo d'Albania) Roma 1 Dhetuer (1904), Vieta I, Nr. 6, fq. 39-40*

Njoftohet se me 9 nandor 1904, u themelue në Braila (Rumani) një shoqni shqiptare e re, me emnin "Dialeria Shcypetare", Kryetar i kësaj shoqnie u zgjodh njëzani Z. Kr. Dak.

322. — DRIN (Pseudonimi):

Nostre Corrispondenze [Korrespondencat tona]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia 30 Maggio 1904, Anno VIII, Nr. 10, fq. 7*.

Çështje të alfabetit. Në lidhje me përçarjen e prelatëve të Shkodrës për punë të alfabetit, autori shkruen se rolin ma të madh në këtë mes e ka luejtun qeveria austriake. Kjo qeveri, thuhet ma posthtë, e mbështeti që në fillim veprimtarinë e shoq. "Bashki-

- mi". Ma vonë Austria, tue pa përparimin e "Bashkimit", e boj-kotoi këtë dhe i kundërvuni shoq. "Agimi" me të vetmin qëllim që t'i përçajë dhe të mos i lejojë Shqiptarët të krijojnë bashkimin kombëtar e letrar, prelude i bashkimit politik.
323. — FIALORI i Kristoforidhit. — *ALBANIA, London, 1904, Viti VIII, Nr. 6, fq. 109*.
Simbas Z. Andréadës, drejtor i *Bulletin d'Orient*, Fjalori i Kristoforidhit asht dërgue në shtyp dhe do të dalë mbrenda këti; vjeti. Ky fjalor, njofton Andréadës, ka ma tepër se 40.000 fjalë.
324. — FJALOR i Kristoforidhit. — *ALBANIA, London 1904, Viti VIII, Nr. 9, fq. 177-178*.
Botohet një jetëshkrim i shkurtër mbi Kristoforidhin, marrë nga fletorja e Athinës *Le Bulletin D'Orient*. Fjalori i Kristoforidhit, thuhet ma poshtë, para se të dergohej në shtyp, u muer nëpër duer nga Z. Hariton, i cili bani vetëm radhitjen e lëndës pa i ndrrue asnjë pikë dorëshkrimit të K. (shih edhe versionin frangjisht *Le Dictionnaire de Kristoforidh*, fq. 198).
325. — GJUHA shqip në Vjenë. — *DRITA, Sofia 30 korrik 1904, Viti III, Nr. 48, fq. 2*.
Shkruhet për rezultatet e mira që ka arritur mësimi i gjuhës shqipe në Vjenë, nën drejtimin e Gj. Pekmezit (Shkrue me alf. e Stambollit).
326. — GRAMMATICA della Lingua Albanese del Prof. D. Gaspare Jakova Merturi con prose e poesie scelte, e con un dizionario dei principali verbi della lingua albanese [Gramatika e gjuhës shqipe e Prof. D. Gaspër Jakova Merturi me prozë e poezi të zgjedhur, e me një fjalor të foljevet kryesore të gjuhës shqipe]. — *LAIMTARI I SHCYPENIES (L'Araldo d'Albania), Romë 15 Nandenuer (1904), Vieta I, Nr. 5 (kopertina)*.
Bibliografi. Riprodhim i një lajmi recensiv mbi veprën e sipërme, marrë nga e përkohëshmjia *Gazzetta Albanese*.
327. — GRAMMATICA della lingua albanese del prof. D. Gaspare Jakova [Gramatika e gjuhës shqipe, nga prof. D.G. Jakova]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Aprile 1904, Anno VIII, Nr. 7, fq. 8-9*.
Riprodhohet tekstualisht pasqyra e lëndës si ma poshtë:
SOMMARIO : Prefazione Unità morfologica della lingua albanese — Ghego e Tosko — Forme etimologiche comparate — Purità etnica delle diverse razze-Polimorfisti e sue ramosse conseguenze politiche-Dialetti italo-albanesi.
Ortografia : Principi - Sistema ortografico di Costantinopoli 1879 - Consonanti - Vocali - E muta - Sistema diacritico.
Grammatica. Declinazioni - Prima declinazione, paradigmi (1-5) ed osservazioni - Seconda declinazione, paradigmi (1-6) ed osservazioni - Terza declinazione, paradigmi (1-5) ed osservazioni — Sostantivi verbali — Aggettivi (paradigmi 1-2 ed A-D) — Numerali — Ordinali — Distributivi — Comparativi — Superlativi — Pronomi (paradigmi 1-16) — Osservazioni.
Verbi. Verbi ausiliari *më pase* e *më këne* — Verbi regolarë. — Prima coniugazione *më mbarue* (finire) — Seconda coniugazione *më padite* (accusare) — Terza coniugazione *më lidhe* (legare) — Quarta coniugazione *m'u binde* (meravigliarsi) — Quinta coniugazione, verbo passivo — Verbi irregolarë — Preposizioni — Avverbi — Congiunzioni — Interiezioni.
Dialoghi 14.
Crestomazia Shcypenia e Shcyperravet (Storia) — *Pieja e mbrëti* (favola) — Canti e poesia popolari — Romanza (Cheto Baske Muji).
Dizionario dei principali verbi della lingua albanese (1346 verbi).
328. — JAKOVA [Gasper]: Statistica delle Colonie Italo-Albanesi [Statistikë e Kolonive italo-shqiptare]. — *LAIMTARI I SHCYPENIES (L'Araldo d'Albania) Frascati (Roma) 15 nandenuer (1904), Vieta I, Nr. 5, fq. 28-29*.
Përmban edhe toponomastikën e dhjetë krahinave të banuemel nga arbëneshët e Italisë.

329. — JAKOVA [Gaspër]: Origini degli albanesi. Cenni storico — filologico [Origjina e Shqipëtarëve. Të çekme historiko-filologjike]. — *LAIMTARI I SHCYPENIES (L'Araldo d'Albania) Frascati (Roma) 15 shtatuer (1904), Vieta I, Nr. 1, fq. 1-3; Nr. 3, fq. 10; Nr. 4, fq. 19; Nr. 5, fq. 26-28.*
Përmban toponime si dhe disa etimologji (simbas teorisë pellazgjike).
330. — JAKOVA [Gaspër]: Illiri, Epiroti, Macedoni [Ilirë, Epirotë, Maqedonë]. — *LAIMTARI I SHCYPENIES (L'Araldo d'Albania) Romë I, Dhetuer (1904), Vieta I, Nr. 6, fq. 34-36; Nr. 7, fq. 42-44; Vieta II, I Kallenduer (1905), Nr. 1, fq. 51-52; Nr. 2, fq. 59-60.*
Përmban edhe disa etimologji toponimesh të lashta.
331. — JAKOVA-MERTURI, Prof. D. GASPËR: L'Albania. Statistica etnografica commerciale [Shqipëria. Statistikë etnografike tregëtare]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 31 Luglio 1904, Anno VIII, Nr. 14, fq. 2 (vv).*
Në shënimin I autori ban këtë vërejtje: Emni Kosova që serbët ma vonë e quajtën *Kosovopolje* = fusha e Kosovës, nuk asht një emën sllav, siç pretendojnë disa, po një shtrembënim i thjeshtë i emnit *Shkup* = (*Shukup*, me metatezë *Kushup*, shtrembënuë në *Kushuv* > *Koshov* > *Kosov*).
Ky punim përmban edhe injaft të dhana për toponomastikën e krahinave të ndryshme të Kosovës.
332. — JAKOVA-MERTURI, Prof. D. GASPARE: Questioni ortografiche [Çeshtje ortografike]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 30 Prilë 1904, Anno VIII, Nr. 8, fq. 4-6.*
Në këtë artikull autori trajton kryesisht problemin e alfabetit të shqipes dhe të ortografisë. Tri institucionet kryesore që sot kanë një farë randësie për gjuhën shqipe, janë: Shoq. e "Bashkimit" "Albania" e Londrës dhe "Shqypetari" i Bukureshtit. Të tria këto kanë adoptue sistemin ortografik në bazë të shkronjave latine, me kombinime siglash, tue përjashtue shenjat diakritike. Pra një bazë e përbashkët egziston. Ma poshtë A. analizon një nga një veçoritë e këtyne alfabeteve, tue propozue edhe mënyrën se si të zhduken ndryshimet e lehta që egzistojnë për disa shkronja në mes të këtyne tri alfabeteve. Në parim A. pëlqen sistemin e "Bashkimit" me kusht që ky sistem të plotësohet me siglat *mb, nd, dxh* dhe me shkronjen *j*. Për shkronjat *gh=g* palatale dhe *é* A. thotë se janë për t'u diskutue. *Dritës së Sofjes*, e cila asht e vetmja që rruen sistemin hibrid të ortografisë së Stambollit, i ban apel të sakrifkohet për interesin e përgjithshëm. Për sistemin diakritik të shoq. "Agimi", nuk jep ndonjë gjykim të premë, mbasi, sikurse shkruen, nuk e njeh.
333. — K[OLONJA], SH[AHIN]: Si begatohet një gjuhë — si duhet bërë për gjuhën shqip. — *DRITA, Sofia 5/18 Janar 1904, Viti III, Nr. 36, fq. 2-3*
Shqipja, shkruen A., jo vetëm që asht një nga gjuhët ma të bukura po edhe ma të begatëshmet. Flet për kompozitat, fjalët e prejardhuna (me anë afiksesh), etj. të cilat po të krijohen në frymën e gjuhës, e pasunojnë mjaft leksikonin e shqipes (Shkrue me, alf. e Stambollit).
334. — [KONICA FAIK]: Ghuha sheipe n'Austrie. — *ALBANIA, London, 1904 Viti VIII, Nr. 6, fq. 107-109.*
Çeljen e një dege të gjuhës shqipe në Universitetin e Vjenës, autori e konsideron si një gjest miqësie të Austrisë.
335. — K[ONICA] F[AIK]: Pétroni i Shecperise. — *ALBANIA, London, 1904 Viti VIII, Nr. (1), fq. 12-17.*
Tue polemizue me Shahin Kolonjën, autori gjatë këtij artikulli prek çeshtje të ndryshme të ortografisë dhe të leksikut (fjalëformimit). Ma poshtë vijon në diskutimin e hapun rreth trajtave kombiar apo kombëtar. Trajtën kombiar, shkruen K., e krijoi 9 vjet ma parë z. Visar A. Dodani, ish drejtor i gazetës "Shqiperia" të Bukureshtit. Ma vonë V. Dodani përdori edhe trajtën kombëtar, tue u dhanë të dyja këtyne fjalëve veshtime të ndryshme: kombiar me veshtirim *national* e kombëtar me veshtirim *nationaliste*. Konica asht i mendimit të përdoret vetëm trajta

- kombëtar*, e sa për kuptimin *national*, shqipja ka udhë të tjera, p.sh. *L'intérêt national* = interesi i kombit, etj. Përsa i përket shkrimit të emrave të huej, Konica thotë se duhen shkruar ashtu siç janë në origjinal, pra: *Shakespaere*, *Corneille*, etj. e jo *Shekspir*, *Kornej*, etj.
336. — K[ONICA], F[AIK]: Shqipia (*sic! recte*: Shecipia) ë Girolamo te Radës. — ALBANIA, London, 1901, Viti VIII, Nr. 8, fq. 155-147.
"Milosaon" e De Radës, autori e gjen në pikëpamje të gjuhës të vështirë e vende-vende të pakuptueshme.
337. — KULLURIOTI, ANASTAS: Vëtevéteriat'ë Bishavët. Vëtevéteriat' ë shpendavët. Vëtevéteriat'ë binmese. — ALBANIA, London, 1904, Viti VIII, Nr. 3, fq. 50-52.
Me që paraqesia interes për leksikon e shqipes, në këtë numër botohen 74 grupe fjalësh (emna dhe folje) nga bota shtazore, bimore, materiale (atmosferike), etj. P.sh. 1) *qeni dhe dhelpna leh, derku e guni gravis, kuu e bualli buarris*, 2) *pula kakaris, bleta zhengon, piguni pigun's*; 3) *ora frin a fermon, shkumri shkumon, shiu shishin*, etj. (Marrë nga *Abavatari Arberor*, Athine, 1882, fq. 48-50).
338. — LEK GRUDA (Pseud. i *Luigj Garakuqit*): Vjërsherimi n'ghÛhe sheype. — ALBANIA, London, 1901, Viti VIII, Nr. 10, fq. 191-195; Nr. 11, fq. 205-212; London 1905, Viti IX, Nr. 1, fq. 17-21; Nr. 2, fq. 38-43; Nr. 3, fq. 64; Nr. 4, fq. 80-82; Nr. 5, fq. 95-100; Nr. 9, fq. 175-178; Nr. 10, fq. 191-197; Nr. 11, fq. 215-217; Nr. 12, fq. 229-230; London 1905, Viti X, Nr. 2, fq. 39-35; Nr. 3, fq. 41-51.
Kurs për të nxanë artin e poezisë. Interes për gjuhësinë në këtë vepër paraqet sidomos *terminologjia* si dhe kapitujt *permi E' p'azashme* dhe *gjuha poetike* (fonetika).
339. — LORECCHIO, ANSELMO: La lingua albanese a Vienna [Gjuha shqipe në Vjenë]. — LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 31 Agosto 1904, Nr. 16, fq. 3-5.
Riprodhim (i përkthyer në italisht) i artikullit me të njejtin titull, botue në gaz. DRITA të Sofjes, Nr. 43, dt. 30 qershor 1904. Këtëj artikulli A. i ban një koment të gjatë me karakter politik.
340. — LORECCHIO, ANSELMO: L'insegnamento della lingua albanese [Mësimi i gjuhës shqipe]. — LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia 15 Settembre 1904, Anno VIII, Nr. 17, fq. 4-6.
Për dijetarët e Europës, me kombësi jo shqiptare, si Askoli, Majeri, Hahni, Ksilanderi, Bealëv, etj. studimi i gjuhës shqipe, shkruen autori, ishte një ushtrim doktrinash morfologjike e filologjike të krahasueme. Zhvillimin e vet shqipja e pati, përfundon A., nga zemra dhe truni i shqiptarit të përhapua dhe të koncentruen nëpër qindra libra e gazeta shqipe të botueme që prej ma se 30 vjetësh në Stamboll, Bukuresht, Sofje e në Kolonitë italo-shqiptare.
341. — LORECCHIO, ANSELMO: La lingua albanese in Austria [Gjuha shqipe në Austrë]. — LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Dicembre 1904, Anno VIII, Nr. 23, fq. 2-3.
Riprodhohet (i përkthyer në italisht) artikulli me të njejtin titull, botue në Albania e F. Konicës, Vjeti 8, Nr. 6, lidhur me çështjen e hapjes së katedrave të gjuhës shqipe në Napoli dhe në Vjenë. Artikulli i masipërm dhe shënimet e Lorekjos marrin një karakter polemiko-politik simbas simpatisë e konsideratave që drejtuesit e Albania-s dhe të La Nazione Albanese-s kanë respektivisht për Austrinë dhe Italinë.
342. — LULOR. (Pseudonim): Sami Beg Frashëri. — LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 15 Luglio 1904, Anno VIII, Nr. 13, fq. 3-4.
Nekrologji për vdekjen e S. Frashërit.
343. — NJË SHOQERI ë ré në Braille "Djelmuria Shqiptarë". — BESA, Le Caire, Shen Endré, 1904, Vit' i I, Nr. 3, fq. 59-60.
Njoftohet se në Braille të Rumanisë filloi veprimtarinë e vet shoqia "Djelmuria Shqiptarë", qëllimi i të cilës asht të përhapnit e gjuhës shqipe. Kjo shoqi do të shtyp libra të dobishme dhe do t'i shpërndajë falas në Shqipni dhe kudo ku ka shqiptarë.

344. — NOTE [Shënime]. — *ALBANIA, London, 1904, Viti VIII, Nr. 6, fq. 125-128.* — Në këto shënime (në frangjisht) flitet:
1. Se fjalori i Kristoforidhit asht dergue në shtyp.
 2. Lordi E. Fitzmaurice në letrën që i dërgoi me 17/7/1880 kontit Granville, ministrit të jashtëm britanik, shkruen fjalë lavdi për Kristoforidhin.
 3. Gazeta *L'Européen* e Parisit kërkon ta paraqesë Kristoforidhin si... grek.
 4. Prek edhe disa çeshtje të llagapeve, ndër to edhe llagapin Kristoforidh.
345. — NOTES Littéraires et linguistiques [Shënime letrare e gjuhësore]. — *ALBANIA, London, 1904, Viti VIII, Nr. 2, fq. 40-41.*
Në këto shënime (në frangjisht) shkruhet:
1. Se Kristoforidhi ka vdekun më 1892, tue i lanë të birit një fjalor të madh në drsh. Ky fjalor, simbas thanjes së Ogyst Dozonit, i cili e ka pa më 1876, përmban rreth 40.000 fjalë. Në një shënim tjetër flitet për emnin e qytetit *Durrës* (Duras, Durës, Durazzo). Flitet edhe për Fjalorin e shoq. "Bashkimi" (shih Nr. 350).
346. — ORTOGRAFIA Albanese (alfabeto) [Ortografia shqipe (alfabeti)] *LAIMTARI SHCYPENIES (L'Araldo d'Albania) Frascati (Roma) 15 shtator (1904), Vjeta I, Nr. 1, fq. (kopertina).*
Botohet një pasqyrë e alfabetit të shqipes me 37 shkronja (latine) si dhe rregullat e leximit. Redaksia lut shkrimtarët që të shkruajnë në bazë të këtij alfabeti. Kjo pasqyrë përsëritet në të gjithë numrat vijues.
347. — REDAZIONE (LA): Per l'alfabeto unico [Për alfabetin e përbashkët]. — *LA NUOVA ALBANIA, Napoli 1 Febbraio 1904, Anno III, Nr. 3, fq. 6-7.*
Botohet një pjesë nga letra e Dr. Xhovani Muzakjo (Giovanni Musacchio) d'Ëruri, i cili shkruen se alfabetet e shumtë që po qarkullojnë e kanë ba shumë të vështirë leximin e kuptimin e shkrimeve shqipe. Në një shënim të sajin Red. njofton se ka pranue alfabetin e "Bashkimit". Riprodhohet një pasqyrë e këtij alfabeti me sqarime për disa tinguj e shkronja që nuk i ka italishtja.
348. — RREGULLA shkronjëtorake të gjuhës shqip. — *DRITA, Sofia, 25 shkurt 1904, Viti III, Nr. 39, fq. 1-2; Nr. 40, fq. 2; Nr. 41, fq. 2-3; Nr. 43, fq. 2-3; Nr. 44, fq. 3; Nr. 46, fq. 2.*
Vazhdim i gramatikës së nisun në Nr. 35 (fq. 1-3 vv.) në *DRITA* me titull: "Shkronjëtorja e gramatika shqip" (Shih Nr. 297). Në këtë pjesë autori trajton të gjashtë "rrenjë e ëmërit" (rasat e emnit), të cilat janë: *quanjëtorë* (em.), *pjellëtorë* (gjind.); *dhënëtorë* (dhan), *kallzonjëtorë* (kall.), *pritëtorë* (vend.), *mërgonjëtorë* (rrjedh.). Autori gjatë gjithë punimit ka parasysh edhe veçoritë e të dy dialekteve të shqipes. (Shkruet me alf. e Stambollit).
349. — SAMI FRASHËRI. — *DRITA, Sofia 14 Qershor 1904, Viti III, Nr. 46.*
Nekrologji me rastin e vdekjes së S. Frashërit (5 qershor 1904). (Shkruet me alf. e Stambollit).
350. — SHENIMË. — *ALBANIA, London, 1904, Viti VIII, Nr. 2, fq. 39.*
1. Njoftohet se Akademia shqipe e "Bashkimit" asht tue pregatitë një fjalor shqip, ma të plotë se të gjithë fjalorët e derisotëm. 2. Shoq. "Bashkimi" u themelue prej Emzot Prend Doçit, abatit të Mirditës. Ptohen gjithë puntorët e gjuhës shqipe të mbli-dhen rreth kësaj shoqnie e të bashkëpunojnë me të (shih edhe versionin frangjisht: *Notes littéraires et linguistiques*, fq. 40).
351. — SHENIMË Ghuësië. — *ALBANIA, London, 1904, Viti VIII, Nr. 3, fq. 52-53.*
1. Fjalën *margaç* e ka vetëm Bardhi te Fjalori, 1635. Kjo fjalë duket se vjen nga lat. *mercatum* (lat. popullorë *mercato*) që do të thotë gomar i tregut. Kurse fjala *gomar* mund të jetë një ndryshim i greq. *ὄναγρος* (gomar i egër), po ka ma tepër mundësi të ketë ardhë nga një fjalë hebraishte. Ma poshtë flitet edhe për këto fjalë. *shyqptonj, guc, tegerr, pafllatar, pigun, korak, etj.*

- Në fund thuhet se do të ishte gabim në qoftë se Fjalori i "Bashkimit" do t'i hiqte të gjitha fjalët turke, si p.sh. *daull*, *top*, *dufek*, *barat*, *fishek*, etj. të cilat sot tingëllojnë si shqipe.
352. — SHENIMË. — ALBANIA, London, 1904. Viti VIII, Nr. 4, fq. 81-82.
Çeshtje ortografie: tingulli *r* në tosk, dhe *n* në geg.; grupi *mb* në tosk. dhe *mm* në geg. dhe pasojat e gabueme të përdorimit të shtrembët të tyne.
353. — SHENIMË. — ALBANIA, London 1904. Viti VIII, Nr. 5, fq. 103-104.
Polemikë me Gaspër Jakovën në lidhje me çeshtje të alfabetit e të ortografisë.
354. — SHENIMË. — ALBANIA, London, 1904. Viti VIII, Nr. 19, fq. 147.
Nga Toskënia pyesin si lexohen fjalët gegënishte *voe*, *oroe* (tosk. *ve*, *vezë*, *re*)? Në përgjigje thuhet se lexohen: geg. *voe*, *oroe* ((fr. *veû*, *oreû*).
355. — SHKODERANI, S.B.: Bëgju i Konitses. Kuvënd. — LAJMTARI I SHCYPENIES (L'Avallò d'Albania) Frascati (Roma) 15 tetuer (1904). Vieta I, Nr. 3, fq. 11-13.
A. kritikon edhe disa neologjizma të Konicës.
356. — SKENDO, TAS.: Fjalator'i K. Kristoforidhit. — BESA, Le Caire. Shen Endrë 1904, Viti I, Nr. 3, fq. 57-59.
Njoftohet dalja në dritë e Fjalorit të Krist. tue dhanë edhe shkaqet që e vonuene daljen e tij. Me këtë rast fjalorit i bahet edhe një recension i shkurtër kritik. Ky fjalor, i cili nuk ka ma tepër se 10,000 fjalë, do të shërbejë si një gur themelor për fjalorë ma të pasun e krejt shqip.
357. — SHKRONJA të mëdha e të vogëla. — DRITA, Sofia 10 Maj 1904. Viti III, Nr. 44, fq. 2.
Për t'u ardhë në ndihmë shqiptarëve që mësojnë me shkruar shqip pa mësuar, autori në këtë artikull jep disa udhëzime didaktike mbi ortografinë dhe shenjat e pikësimit. (Shkruar me alf. e Stambollit)
358. — SQUIRO (Skirò, Z.): Mbi Abëtaren. — FLAMURI I SHQIPERËS (La Bandiera Albanese). Napoli, 1 të Kalendorit 1904, viti I, Nr. ?.
Në lidhje me alfabetet e shqipes, autori shkruen se alfabeti i Stambollit nuk asht ai që i nevojitet gjuhës shqipe.
359. — THIR[ANK] SP[IROBEG] (Pseud. i Faik Konicës): De l'ëtymologie de mot ALBANIE [Nga etimologjia e fjalës SHQIPNI]. — ALBANIA, London, 1904, Nr. 1, fq. 18-19.
Pikëpamja e Lajbnicit se fjala *Albanie* asht me origjinë keltike, autorit nuk i duket e qëndrueshme. Konicë shkruen se fjala *Albanie* nuk ka qenë e njohun para shek. VIII. Para kësaj kohe shqiptarët quheshin ilirianë, epirotë dhe maqedonë. Fjala *Shqipëri* që do të thotë vend i shqiptonjave, padyshim ka lidhje me legjenden e Pirros. Tue përfundue K. thotë se fjalët *Albanie* dhe *Shqiperi* janë identike, e para nuk asht gja tjetër veçse përkthimi i së dytës, mbasi fjala *alban* në gjuhën romane tregun një zog shtektar, një "aubrier" sikundër thotë Rënuard (Renouard), një "Stossvogel", sikundër thotë Fridrih Diz (Friedrich Diez). Pra përkthimi i fjalës *Shqipëri* në *Albani* me sa duket u ba në shek. e VIII, nën ndikimin e lidhjeve fetare të vendit tonë me botën latine.
360. — TURK, KAUR. — DRITA, Sofia 5/18 shkurt 1904, Viti III, Nr. 38, fq. 2-3.
Kuptimi i hershëm i fjalëve *turk*, *kaur* dhe kuptimi i ri që muercën në gjuhën shqipe. (Shkruar me alf. e Stambollit).
361. — TURK, KAUR (Turco, gjauro). — LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanaro) Italia, 15 Marzo 1904, Anno VIII, Nr. 5, fq. 5-6.
Riprodhim (në gjuhën italyane) i artikullit me të njëjtin titull botue në DRITA Sofie, 1904/III/38/2. (Shih Nr. 360).

362. — UNA Cattedra di lingua albanese in Roma? [Një katedër e gjuhës shqipe në Romë?]. — *LA NAZIONE ALBANESE, Pallagorio (Catanzaro) Italia, 30 Settembre 1904, Anno VIII, Nr. 18, fq. 6.*
Botohet një letër e një lexuesi, me anën e të cilës kërkohet që t'i tërhiqet vemendja qeverisë italiane për çeljen e një katedre të gjuhës shqipe edhe në Universitetin e Romës.
363. — VDEKJET E motit 1903. — *KALENDARI KOMBIAR, Sofia, 1904, mot'i tetë, fq. 26-27.*
Njoftohet vdekje e Jeronim De Radës (ne shkurt 1903). Botohet fotografia si dhe një përmbledhje e shkurten e jetes dhe e veprave të De Rades. (Shkrue me alf. e Stambollit)
364. — XXX.: Ipeiros kai Alvania apandisis to kirio grammatei toy ellinizmoi K. Hristovasilii [Epiri dhe Shqipëria përgjigje zotit sekretar të helenizmit K. Kristovasilit]. — *BESA, Le Caire, Shen'Endrë, 1904, Viti I, Nr. 3, fq. 44-48.*
Permban edhe disa etimologji.
365. — ZEDHENJE: Fjaletori shqip i K. Kristoforidhit. — *BESA, Le Caire, Vjeshhtë III 1904, Vit'i I rë, Nr. 2, fq. 40.*
Njoftohet se Fjalori i Kristoforidhit ka për të dalë se shpejti në dritë nën kujdesin e S. Pecit, të cilit qeveria greke ia dha për botim. —

